



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2022

VENDIM

Nr. 60, datë 15.02.2022

PËR

VLERËSIMIN ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARIT {...} PËR VITIN 2019

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenet 85, 89 dhe 95, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe nr. 264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, pasi shqyrtoi “Projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, për vitin 2019”, i hartuar nga relatore znj. Brikena Ukperaj,

V E N D O S I :

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, për vitin 2019”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:
 - A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
 - C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shumë mirë”.Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shumë mirë”.
 2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
 3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

**ANALIZA E TË DHËNAVE TË MARRA NGA BURIMET E
VLERËSIMIT DHE PËRCAKTIMI I NIVELIT TË VLERËSIMIT PËR
ÇDO KRITER VLERËSIMI**

1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit në drejtim të aspekteve të njohurive ligjore dhe arsytimit të vendimit, vlerësuesi përqendrohet në metodologjinë e përgjithshme të punës së gjyqtarit bazuar në dosjet e përzgjedhura dhe nuk vlerëson meritat ligjore të vendimeve individuale, të cilat përcaktohen vetëm në kuadër të një procesi ankimimi. Aftësia profesionale e gjyqtarit pikëzohet sipas dy aspekteve, njohuritë ligjore dhe arsytimi ligjor, të cilët ndahen në disa nën tregues.

1. A Njohuritë ligjore.

1.A.a Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave.

Roli i gjyqtarit në identifikimin e natyrës së çështjes dhe ligjin e zbatueshëm paraqet rëndësi thelbësore për një sërë çështjesh eventuale që do të duhet të zgjidhë gjykata në përfundim të gjykimit, që në kontekstin e të tërës përkthehet me aksiomën juridike “*Iura novit curia*” – “*Gjykata e njeh ligjin*”. Në këtë kontekst, gjyqtarit i duhet të përcaktojë drejt faktet e çështjes, nga e cila do të përcaktohet më pas natyra juridike e saj, e për pasojë edhe referenca relevante ligjore për zbatim në zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:

- *Në lidhje me përshkrimin e fakteve të çështjes*

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, rezulton se në përgjithësi gjyqtari evidenton në mënyrë të përmbledhur rrethanat e çështjes, duke vënë theksin tek faktet relevante dhe duke i analizuar ato në mënyrë të qartë. Gjyqtari kujdeset që të përshkruajë dhe analizojë faktet thelbësore çështjes (*civile, familjare apo penale*), përshkrim ky i cili realizohet duke u ndërthurur me prova konkrete apo bazuar në tërësinë e provave të marra në gjykim, të vlerësuara në mënyrë të integruar me njëra tjetrën. Përrjashtimisht, në një prej vendimeve të analizuar, i cili i përket kategorisë së vendimeve jopërfundimtare¹ (*vendim për pushimin e gjykimit*), gjyqtari përshkruan vetëm rrethanat procedurale të çështjes pasi faktet thelbësore të saj nuk janë bërë objekt vlerësimi në kushtet kur çështja është pushuar.

Përgjithësisht, konstatohet se pavarësisht natyrës së çështjes (*civile, familjare apo penale*), përshkrimi i rrethanave të faktit zhvillohet në fillim të pjesës përshkruese-arsyetuese të

¹ Vendimi nr. 126-615, datë 25.02.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

vendimit, menjëherë pas konkluzionit të gjykatës mbi padinë e paditësit apo kërkesën e prokurorit. Në ndonjë rast, përshkrimi i rrethanave të faktit zhvillohet vetëm në pjesën e vlerësimit të gjykatës². Në çdo rast, faktet thelbësore të çështjes jo vetëm pasqyrohen por analizohen në tërësinë e tyre, dhe mbahen në konsideratë në pjesën e analizës për efekt të vlerësimit të bazueshmërisë ose jo të kërkesëpadisë (*në rastin e çështjeve civile apo familjare*) apo të ekzistencës së veprës penale, autorësinë e të pandehurit, apo bazueshmërinë e kërkesës penale objekt shqyrtimi (*në rastin e çështjeve/kërkesave penale*).

- Identifikimi i natyrës së çështjes

Referuar të gjitha vendimeve të analizuara, rezulton se gjyqtari nuk ndalet në trajtimin e mëvetësishëm të natyrës së çështjes. Kjo e fundit, zbulohet rast pas rasti duke iu referuar mosmarrëveshjes në gjykim, si dhe ligjit të aplikuar për zgjidhjen e saj. Pavarësisht kësaj, konstatohet se në të gjithë vendimet e analizuara, në pjesën hyrëse të vendimit përkatës, gjyqtari specifikon sipas rasti natyrën civile apo penale të çështjes në gjykim.

- Në drejtim të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm

Identifikimi i saktë i natyrës së çështjes lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë edhe me identifikimin e ligjit të zbatueshëm në zgjidhjen e saj. Në këtë aspekt, referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se gjyqtari identifikon ligjin e zbatueshëm, duke treguar gjithashtu kujdes në mos citimin apo listimin e dispozitave ligjore, të cilat nuk kanë lidhje dhe nuk të referojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjes objekt shqyrtimi.

Sa i përket ligjit material të zbatueshëm, nisur nga objekti dhe shkaku i kërimit në çështjet civile/familjare, si dhe kërkitimi i prokurorit në çështjet/kërkesat penale, gjyqtari ka identifikuar ligjin e zbatueshëm në çështjet si më poshtë:

- (i) Në vendimin për çështjen civile (*i cili ka për objekt kërkitimi detyrimin e të paditurve për lejimin e paditësin të kalojë në pasurinë e paluajtshme në pronësi të tyre*) identifikon nenin 277 të K. Civil në lidhje me kushtet që duhet të verifikohen për servitutin e kalimit.³
- (ii) Në vendimet për çështjet familjare (*të cilët kanë për objekt zgjidhjen e martesës me kërkesë të njërit bashkëshort*), identifikon
 - nenin 132 të K. Familjes në lidhje me kushtet ligjore që duhet të verifikohen për zgjidhjen e martesës me kërkesë të njërit bashkëshort.⁴;
 - nenin 146 të K. Familjes në lidhje me përcaktimin e mbiemrit që do të mbajë pas zgjidhjes së martesës bashkëshorti i cili e ka ndërruar atë si rezultat i lidhjes së martesës.⁵

(iii) Në vendimet për çështjet/kërkesat penale (*në lidhje me akuzën për veprën penale të parashikuar nga nenet 130/a/4, 321/2, 236/1, 278/1 dhe 237 të K. Penal, dërgimin në gjyq dhe pushimin e procedimit penal, verifikimin e kushteve dhe kriterëve për vazhdimin e*

² Vendimi nr. 729, datë 19.11.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

³ Vendimi nr. 729, datë 19.11.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

⁴ Vendimet nr. 534-2363, datë 09.09.2019 dhe nr. 751-3274, datë 22.11.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

⁵ Vendimet nr. 534-2363, datë 09.09.2019 dhe nr. 751-3274, datë 22.11.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

zbatimit të masës së sigurimit) gjyqtari identifikon dispozitat e ligjit material të zbatueshëm si më poshtë:

- Nenet 130/a/4, 321/2, 236/1, 237, 283/1, 278/1 dhe 291 të K. Penal në kuadër të cilësimit juridik të faktit penal.⁶
- Ligjin nr. 7975/1995, për të evidentuar se mbajtja e lëndës narkotike e llojit Cannabis Sativa L në mënyrë të paautorizuar vjen në kundërshtim me të.⁷
- Nenin 184 të K. Rrugor, për të vlerësuar pasojat në rastin e refuzimit të verifikimit për pije alkoolike.⁸
- Dispozitat materiale në funksion të individualizimit të dënimit, përkatësisht nenin 34 të K. Penal në lidhje me dënimin me gjobë, nenet 47-50 të K. Penal në lidhje me mënyrën e caktimit të dënimit, rrethanat lehtësuese dhe rënduese, nenin 55 të K. Penal në lidhje me caktimin e dënimeve për disa vepra penale, si dhe nenin 59 të K. Penal në lidhje me pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënien në provë.⁹

Sa i përket ligjit procedural të zbatueshëm, nisur nga kërkesat procedurale të palëve, rrethanat procedurale të gjykimit apo natyra e gjykimit dhe vendimmarrjes, gjyqtari ka identifikuar dispozitat si më poshtë.

(i) Në vendimet për çështjet civile:

- Nenin 186 të K. Pr. Civile në lidhje me rrethanat procedurale të cilat lejojnë marrjen e provave të reja, pas nxjerrjes së urdhrit për caktimin e seancës gjyqësore.¹⁰
- Nenin 286 të K. Pr. Civile në lidhje këqyrjen në vend.¹¹
- Nenin 179/2 të K. Pr. Civile në lidhje me kushtet që duhet të verifikohen për pushimin e gjykimit për shkak të mosparaqitjes së paditësit në seancë përgatitore/gjyqësore.¹²

(ii) Në vendimet për çështjet familjare:

- Nenin 143 të K. Familjes në lidhje me dërgimin e vendimit për zgjidhjen e martesës për regjistrim pranë Zyrës së Gjendjes Civile përkatës, pasi të ketë marrë formë të prerë, si dhe nenin 106 të K. Pr. Civile në lidhje me shpenzimet gjyqësore.¹³

(iii) Në vendimet për çështjet penale:

- Nenin 34/b të K. Pr. Penale në lidhje me të drejtat e personit të arrestuar ose të ndaluar; nenin 238 të K. Pr. Penale në lidhje me masën e sigurimit “Arrest në burg”; nenin 248 të K. Pr. Penale në lidhje me marrjen në pyetje të personit të arrestuar.¹⁴
- Nenin 190 të K. Pr. Penale në lidhje me disponimin për provat materiale.¹⁵

⁶ Vendimet nr. 70, datë 21.02.2019, nr. 190/1082, datë 08.04.2019, nr. 93-1230, datë 19.04.2019 dhe nr. 241-2792, datë 10.10.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

⁷ Vendimi nr. 190/1082, datë 08.04.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

⁸ Vendimi nr. 241-2792, datë 10.10.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë

⁹ Vendimet nr. 70, datë 21.02.2019 dhe nr. 241-2792, datë 10.10.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

¹⁰ Vendimi nr. 729, datë 19.11.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

¹¹ Vendimi nr. 729, datë 19.11.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

¹² Vendimi nr. 126-615, datë 25.02.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

¹³ Vendimet nr. 534-2363, datë 09.09.2019 dhe nr. 751-3274, datë 22.11.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

¹⁴ Vendimi nr. 93-1230, datë 19.04.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

¹⁵ Vendimi nr. 241-2792, datë 10.10.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

- Nenin 201/a të K. Pr. Penale në lidhje me marrjen me detyrim të kampionëve biologjikë.¹⁶
 - Nenin 393 të K. Pr. Penale në lidhje me shpenzimet gjyqësore.¹⁷
 - Nenin 328 të K. Pr. Penale në lidhje me rrethanat kur vendoset pushimi i akuzës/çështjes dhe nenin 329/b të K. Pr. Penale në lidhje me shqyrtimin e kërkesës së prokurorit për pushimin e akuzës/çështjes.¹⁸
 - Nenin 332/ë të K. Pr. Penale në lidhje me përmbajtjen e fashikullit të gjykimit.¹⁹
 - Nenin 406 të K. Pr. Penale në lidhje me procedurën e gjykimit të shkurtuar.²⁰
- *Në lidhje me konfliktin e normave*

Në vendimet gjyqësore të analizuara nuk rezulton të jetë evidentuar nga gjyqtari ndonjë rast i konfliktit të normave ligjore. Nuk konstatohet asnjë rast ku analiza e konfliktit të normave të ketë qenë e domosdoshme.

KONKLUZIONE

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të mira në identifikimin e qartë dhe të saktë të fakteve të çështjes dhe përshkrimin e tyre, si dhe identifikimin e normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim, në funksion të zgjidhjes së çështjes.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 25 pikë.

1.A.b Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes.

Interpretimi, si funksion dhe metodë duhet ti japë jetë normave materiale dhe procedurale relevante, përmes kuptimit të drejtë të përmbajtjes dhe qëllimit të tyre në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes/çështjes.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:

- *Në lidhje me interpretimin e ligjit të zbatueshëm*

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, evidentohet se gjyqtari referon dhe në disa raste përshkruan në mënyrë të përmbledhur përmbajtjen e ligjit material apo procedural të zbatueshëm, nisur nga rrethanat faktike apo procedurale të çështjes. Gjithashtu, evidentohet se gjyqtari përgjithësisht nuk zhvillon interpretim të mëvetësishëm të normave materiale apo procedurale të identifikuar, por i zbaton ato në mënyrë të

¹⁶ Vendimi nr. 241-2792, datë 10.10.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

¹⁷ Vendimet nr. 70, datë 21.02.2019 dhe nr. 241-2792, datë 10.10.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

¹⁸ Vendimi nr. 190/1082, datë 08.04.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

¹⁹ Vendimi nr. 190/1082, datë 08.04.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

²⁰ Vendimet nr. 70, datë 21.02.2019 dhe nr. 241-2792, datë 10.10.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

drejtëpërdrejtë mbi rrethanat e çështjes, për të konkluduar më pas në lidhje me bazueshmërinë ose jo të kërkimit të paditësit (*në çështjet civile/familjare*) apo të kërkesës së prokurorit (*në rastin e çështjeve/kërkesave penale*).

- Në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës

Gjyqtari njih dhe zbaton parimet materiale dhe procedurale të së drejtës, edhe pse nuk i përmend shprehimisht. Konkretisht, evidentohet se gjyqtari zbaton:

- (i) Parimin e procesit të rregullt gjyqësor, duke garantuar të drejtën për t'u njoftuar, dëgjuar dhe mbrojtur në gjykim, duke zhvilluar një proces kontradiktor²¹;
- (ii) Parimin e disponibilitetit të paditësit²²;
- (iii) Parimin procedural të provueshmërisë së fajësisë së të pandehurit "*përtej çdo dyshimi të arsyeshëm*"²³;
- (iv) Parimin e ligjshmërisë²⁴ ;
- (v) Parimet e përgjithshme në caktimin e dënimit, si të barazisë para ligjit, të drejtësisë në caktimin e fajësisë dhe të dënimit, si dhe të humanizmit ²⁵.

- Në lidhje me aftësinë e gjyqtarit për të përdorur jurisprudencën relevante.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, nuk rezultojnë në asnjë rast që gjyqtari të ketë identifikuar dhe përdorur jurisprudencë gjyqësore vendase apo ndërkombëtare.

KONKLUZIONE

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezultojnë se gjyqtari nuk zhvillon interpretim të ligjit të identifikuar, por e zbaton në mënyrë të drejtëpërdrejtë atë. Interpretimi i ligjit procedural dhe posaçërisht atij material në zgjidhjen e çështjes rezultojnë në mënyrë të kufizuar, vetëm në disa nga vendimet burim vlerësimi, ndërsa në pjesën tjetër dispozitat referohen dhe zbatohen drejtëpërdrejt mbi faktet e çështjes, pa u bërë më parë një interpretim paraprak i tyre në drejtim të identifikimit të qëllimit, elementëve përbërës dhe zbrërthimit të tyre. Gjithashtu, nuk evidentohet në asnjë rast identifikimi dhe referimi në praktikën gjyqësore relevante, çka do të jepte vlerë të shtuar interpretimit të ligjit, në mbështetje të konkluzioneve të arritura mbi zbatimin e tij, kushtëzuar kjo edhe nga natyra e çështjeve të cilat paraqiten përgjithësisht jo komplekse. Duke iu referuar burimeve të vlerësimit në tërësi, rezultojnë se interpretimi i ligjit të zbatueshëm, nuk rezultojnë në të njëjtën shkallë në të gjitha vendimet pasi gjyqtari përgjithësisht referon dhe aplikon drejtëpërdrejt ligjin mbi faktet, duke i lidhur ato me konkluzionet e arritura, por nuk ndalet në interpretimin e ligjit dhe dhënien e arsyeve konkrete për mënyrën e zbatimit të tij mbi faktet e çështjes.

²¹ Në të gjitha kategoritë e vendimeve, civile, familjare apo penale.

²² Vendimi nr. 729, datë 19.11.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

²³ Vendimi nr. 190/1082, datë 08.04.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

²⁴ Në të gjitha vendimet penale.

²⁵ Vendimet nr. 70, datë 21.02.2019 dhe nr. 241-2792, datë 10.10.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet “Mbi mesatere”, duke u pikëzuar me 20 pikë. Ky konkluzion bazohet në analizën e metodologjisë së përgjithshme të punës së gjyqtarit në drejtim të këtij treguesi, duke analizuar të gjitha llojet e çështjeve të përzgjedhura, pa i dhënë peshë dhe rëndësi të veçantë asnjërës prej tyre.

1.B Arsyetimi ligjor

1.B.a Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit.

Shkrimi ligjor duhet të karakterizohet nga disa tipare që e bëjnë të qëndrueshëm, siç janë: qartësia, saktësia, konciziteti dhe komponenti analitik. Ai duhet të paraqesë pa ndërprerje një pamje të qartë, të shpejtë dhe të plotë të çështjes. Vendimi gjyqësor nuk duhet të dominohet nga përshkrimi i provave, por nga pjesa analitike, e cila në vetvete duhet të jetë koncize, pa përsëritje dhe të trajtojë çështjet thelbësore.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:

Referuar burimeve të vlerësimit të analizuar në raportin analitik, evidentohet se gjuha e përdorur nga gjyqtari në dokumentet ligjore të dorëzuara prej tij, aktet dhe vendimet gjyqësore të dosjeve të përzgjedhura me short është e thjeshtë, e drejtpërdrejtë, e qartë dhe e kuptueshme. Gjyqtari kujdeset të përdorë terminologji korrekte dhe teknike, aty ku është i pashmangshëm përdorimi i saj, sikundër parashikohet shprehimisht, p.sh në ligjet e posaçme të referuara nga ana e gjyqtarit në lidhje me ligjin e zbatueshëm, apo në aktet e ekspertimit të përdorur nga ekspertët me njohuri të posaçme, të ndryshme nga aktet juridike. Nuk evidentohet përdorimi i fjalëve që cenojnë integritetin e personit, si dhe tregohet kujdes në shmangien e përdorimit të fjalëve fyese apo denigruese.

Sa i takon aspektit gramatikor, gjyqtari tregon kujdes për mënyrën e ndërtimit të fjalive dhe paragrafëve, duke respektuar rregullat e gjuhës shqipe. Evidentohet se, edhe në rastet e ndërtimit të fjalive të gjata, kjo bëhet me qëllim që të mos ndërpritet kuptimi i mendimit dhe pa humbur qartësinë e tij. Ndërtimi i paragrafëve karakterizohet nga lidhja e tyre me njëri-tjetrin përmes kronologjisë së mendimit. Përgjithësisht, përdor të gjitha shkronjat e alfabetit shqip, por në disa raste shkronjat “ç” dhe “ë” nuk përdoren në mënyrë konsistente.

KONKLUZIONE

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se gjyqtari ka aftësi shumë të lartë të arsyetimit ligjor, në drejtim të qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë së vendimit. Mënyra e organizimit dhe shprehjes së mendimit në arsyetimin e vendimeve, përdorimi i thjeshtë dhe i drejtpërdrejtë i gjuhës, përzgjedhja e fjalëve, organizimi i tyre në fjali dhe më pas në paragrafë të lidhur me njëri tjetrin sipas linjës së arsyetimit të vendimeve, reflekton qartësi dhe thjeshtësi në arsyetimin e vendimeve gjyqësore. Në këtë mënyrë, vendimet janë të qarta dhe të kuptueshme, jo vetëm për njohësit e ligjit, por edhe për një lexues me njohuri mesatare.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 15 pikë.

1.B.b Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit.

Organizimi i arsytimit ligjor duhet të përcaktojë nëse lexuesi i saj, do ta kuptojë dhe të bindet nga argumentet e përdorura nga gjyqtari. Nëse gjyqtari në dhënien e argumenteve ligjore nuk do të ndjekë një strukturë të qartë, shumë nga pikat kryesore të vendimit mund të humbasin apo mund të mos kuptohen drejt. Në këtë kontekst, është thelbësore që arsytimi të ndjekë një format të qartë organizimi në funksion të orientimit të lexuesit dhe kuptueshmërisë së përmbajtjes së vendimit gjyqësor. Edhe pse nuk ka një unifikim në lidhje me mënyrën e strukturimit të një vendimi gjyqësor, e për pasojë i jep një liri gjyqtarit në strukturimin e tij, nga ana tjetër, referuar rregullave të shkrimit dhe arsytimit ligjor, shkrimi ligjor ka strukturën e tij specifike që juristët/gjyqtarët duhet ta përdorin në një formë apo në një tjetër. Pavarësisht nëse ndiqet metoda IRAC (*Çështje, Ligj, Argumentim, Konkluzion*) apo CRAC (*Konkluzion, Ligj, Argumentim, Konkluzion*) etj., të gjitha këto metoda duhet të jenë në funksion të argumentimit ligjor të përdorur nga gjyqtari në zgjidhjen e çështjes, duke shtruar çështjen/pyetjen për zgjidhje, normën relevante që do të duhet të zbatohet për zgjidhjen saj, analizën e fakteve përkatëse në lidhje me çështjen e shtruar për zgjidhje dhe konkluzioni i arritur.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, rezulton se gjyqtari ndjek një strukturë të qëndrueshme dhe të organizuar në hartimin e vendimit. Konkretisht, vendimet gjyqësore burim vlerësimi, përmbajnë pjesën hyrëse, pjesën përshkuese - arsyetuese, si dhe dispozitivin e vendimit.

Në pjesën hyrëse gjejnë pasqyrim të dhënave të regjistrimit të çështjes, trupi gjykues dhe sekretarja gjyqësore, data e shqyrtimit, palët, objekti i çështjes dhe baza ligjore, si dhe kërkimet përfundimtare të subjekteve pjesëmarrës në proces.

Në pjesën përshkuese arsyetuese përgjithësisht gjejnë pasqyrim rrethanat e çështjes, ku përshkruhen në mënyrë të përmbledhur rrethanat faktike të çështjes dhe/ose ato procedurale, si dhe vlerësimi i gjykatës, ku përfshihet analiza e zhvilluar prej gjykatës për zgjidhjen e çështjes.²⁶

Në pjesën e dispozitivit gjen pasqyrim disponimi i gjykatës për zgjidhjen e çështjes, e drejta e ankimit dhe data e shpalljes së vendimit. Konstatohet gjithashtu se dispozitivi i vendimit është i plotë dhe në të gjejnë pasqyrim të gjitha parashikimet e nevojshme në kuadër të zgjidhjes së çështjes. Konkretisht: në vendimet për çështjen civile gjen pasqyrim disponimi

²⁶ Në vendimin nr. 729, datë 19.11.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, konstatohet se pjesa përshkuese-arsyetuese fillon me pretendimet e palëve dhe provat përkatëse e më pas vazhdon me vlerësimin e gjykatës, ku përfshihen edhe faktet e çështjes.

për rrëzimin e padisë dhe shpenzimet gjyqësore; në vendimet për çështjet familjare gjen pasqyrim disponimi i gjykatës për pranimin e padisë (*duke zgjidhur martesën*), për mbiemrin e të paditurit që rezulton të jetë ndryshuar si pasojë e lidhjes së martesës, për shpenzimet gjyqësore, si dhe parashikimi për dërgimin e vendimit Zyrës së Gjendjes Civile pasi vendimi të ketë marrë formë të prerë; në vendimet për çështjet penale gjen pasqyrim disponimi i gjykatës për fajësinë ose pafajësinë e të pandehurit, për dënimin përkatës në rastin e fajësisë, për masat e sigurimit dhe provat materiale (*kur ka të tilla*), si dhe për shpenzimet gjyqësore; në vendimet për kërkesat penale gjen pasqyrim disponimi i gjykatës për pranimin e kërkesës së prokurorisë dhe përkatësisht pushimin e hetimeve në ngarkim të të pandehurit për veprën penale të parashikuar nga neni 283/1 i K. Penal, dërgimin në gjyq të çështjes në ngarkim të të pandehurit për veprën penale të parashikuar nga neni 291 i K. Penal, parashikimi se gjykimi do të bëhet nga një tjetër trup gjykues me një gjyqtar, si dhe parashikimi në lidhje me përmbajtjen e fashikullit të hetimit.

Referuar analizës së mësipërme, konstatohet se vendimet gjyqësore përmbajnë të gjithë elementët e parashikuar në ligjin procedural përkatës dhe konkretisht: elementët e parashikuar në nenin 310 të K. Pr. Civile në vendimet për çështjet civile dhe familjare; elementët e parashikuar në nenin 332/e të K.Pr.Penale në vendimet seancë paraprake; elementët e parashikuar në nenin 383 të K.Pr.Penale në vendimet penale.

KONKLUZIONE

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se gjyqtari ka aftësi shumë të larta në ndjekjen e një strukture të qëndrueshme dhe të mirëorganizuar të vendimit, në funksion kuptueshmërisë së tij dhe orientimit të lexuesit.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 10 pikë.

1.B.c Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik.

Vendimet duhet të arsyetohen, përndryshe janë të pavlefshme.²⁷Ndonëse nuk kërkohet shprehimisht në nenin 6 të KEDNJ-së, e drejta e një vendimi të arsyetuar bën pjesë në të drejtën e një gjykimi të drejtë siç garantohet nga neni 6, pika 1 i KEDNJ-së, dhe gjen zbatim si në çështjet civile ashtu dhe ato penale. GjEDNJ-ja është shprehur se, megjithëse gjykatave u lejohet një liri e konsiderueshme veprimi, përsa u përket strukturës dhe përmbajtjes, ato janë të detyruara të shprehin me qartësinë e duhur arsyet mbi të cilat ato i mbështesin vendimet e tyre me qëllim që subjekti ta ushtrojë realisht të drejtën që ka për t’u ankuar.²⁸ Arsyetimi i vendimit duhet të tregojë zgjidhjet e të gjitha çështjeve procedurale dhe të thelbit/meritore, të së drejtës dhe të faktit, me të cilat është dashur të përballet gjyqtari për të

²⁷ Neni 142 i Kushtetutës së RSH-së.

²⁸ Vendimi i GjEDNJ, Çështja “Suominen kundër Finlandës”, 24 korrik 2003, paragrafët 34-38 si dhe çështja Hadjanastassiou vs Greqisë, dt. 16.12.1992, fq. 33

justifikuar vendimin e shprehur në dispozitiv. Konkluzioni i vërtetuar në dispozitiv të vendimit duhet të arsyetohet, duke parashtruar procesin logjik, nëpërmjet të cilit është arritur tek bindja e formuar.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, evidentohet se gjyqtari ka aftësi shumë të mira në paraqitjen dhe analizën e fakteve të çështjes, analizë e cila fokusohet në faktet thelbësore të çështjes, duke integruar analizën e provave, në funksion të vërtetimit të tyre. Gjithashtu, evidentohet se gjyqtari ka aftësi shumë të mira në identifikimin e marrëdhënies shkak-pasojë. Kjo e fundit, nxjerr në pah thelbin e mosmarrëveshjes dhe në mënyrë logjike zhvillon lidhjen me institutet e së drejtës të aplikuar në zgjidhjen e çështjes konkrete (*civile, familjare apo penale*).

Por, duhet theksuar se megjithëse gjyqtari aplikon institutet e së drejtës në përputhje me thelbin mosmarrëveshjes, ky aplikim ka natyrë të drejtpërdrejtë. Në asnjë prej vendimeve gjyqësore nuk evidentohet që gjyqtari të ketë zhvilluar teorikisht institutin e së drejtës të aplikuar, natyrën dhe kriteret ligjore të tij, e më pas të ketë vijuar me përjasjen e tyre në rrethanat e çështjes konkrete. Në çdo rast, gjyqtari ballafaqon faktet e çështjes me institutin apo dispozitën ligjore të aplikuar dhe evidenton përputhjen ose mospërputhjen e tyre, për të konkluduar më pas në lidhje me zgjidhjen e çështjes, por duke i kushtuar më tepër rëndësi analizës së fakteve të çështjes dhe provave të administruara, në raport me interpretimin e ligjit të zbatueshëm dhe mënyrën e aplikimit të tij mbi këto fakte apo rrethana.

Konkretisht, në vendimin për çështjen civile²⁹, pasi evidenton rrethanat e faktit relevante për çështjen objekt gjykimi, gjyqtari i ballafaqon ato në mënyrë të nënkuptuar me përmbajtjen e nenit 277 të K. Civil. Mbi këtë bazë, ai evidenton rrethanat mbi të cilat konkludon se nuk verifikohen kushtet e zbatimit të këtij neni.

Në vendimet për çështjet familjare³⁰, pasi evidenton rrethanat e faktit relevante për çështjen objekt gjykimi, gjyqtari përshkruan në mënyrë të përmbledhur përmbajtjen e nenit 132 të K. Familjes për zgjidhjen e martesës me kërkesë të njërit bashkëshort. Duke ballafaquar rrethanat e evidentuara me përmbajtjen e nenit 132 të K. Familjes, gjyqtari konkludon për verifikimin e zbatimit të tij, e rrjedhimisht për zgjidhjen e martesës. Gjithashtu, gjyqtari zbaton në mënyrë të drejtpërdrejtë nenin 146 të K. Familjes në lidhje me përcaktimin e mbiemrit që do të mbajë pas zgjidhjes së martesës bashkëshorti i cili e ka ndërruar atë si rezultat i lidhjes së martesës, si dhe nenin 143 të K. Familjes në lidhje me dërgimin e vendimit për zgjidhjen e martesës për regjistrim pranë Zyrës së Gjendjes Civile përkatës, pasi të ketë marrë formë të prerë.

Në vendimet për çështjet penale³¹, gjyqtari evidenton veprimet konkrete të kryera prej të pandehurit dhe më pas i ballafaqon ato me dispozitën përkatëse të K. Penal, për të cilën jep përmbajtjen në mënyrë të përmbledhur. Mbi këtë bazë, konkludohet në lidhje me fajësinë ose

²⁹ Vendimi nr. 729, datë 19.11.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

³⁰ Vendimet nr. 534-2363, datë 09.09.2019 dhe nr. 751-3274, datë 22.11.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

³¹ Vendimet nr. 70, datë 21.02.2019 dhe nr. 241-2792, datë 10.10.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

jo të të pandehurit. Gjithashtu, në rastet e vërtetimit të fajësisë, gjyqtari individualizon dënimin duke mbajtur në konsideratë përmbajtjen e neneve 47-50 të K. Penal.

Në vendimin për kërkesat penale për dërgimin e çështjes në gjyq dhe pushimin e akuzës³², gjyqtari evidenton veprimet konkrete të kryera prej të pandehurit dhe më pas i ballafaqon ato me dispozitën përkatëse të K. Penal, për të cilën jep përmbajtjen në mënyrë të përmbledhur. Mbi këtë bazë, duke mbajtur në konsideratë kërkesat e nevojshme procedurale për dërgimin e çështjes në gjyq apo pushimin e saj, referuar dispozitës përkatëse procedurale të identifikuar, gjyqtari jep konkluzionin e tij.

Në vendimin për verifikimin e kushteve dhe kritereve për vazhdimin e zbatimit të masës së sigurimit³³, pasi zhvillon analizën e pretendimeve të ngritura prej të arrestuarit dhe vlerën provuese të dokumenteve të paraqitura prej tij, gjyqtari konkludon mbi vazhdimin e zbatimit të masës së sigurimit “*Arrest në burg*” parashikuar nga neni 238 i K. Pr. Penale.

Së fundi, në vendimin civil për pushimin e gjykimit³⁴, gjyqtari përshkruan rrethanat procedurale të gjykimit dhe referon në nenin 179/2 të K. Pr. Civile, duke dhënë edhe përmbajtjen e tij. Duke zhvilluar ballafaqimin e rrethanave procedurale me përmbajtjen e nenit 179/2 të K. Pr. Civile, gjyqtari konkludon për verifikimin e zbatimit të tij, e rrjedhimisht pushimin e gjykimit të çështjes.

Në tërësi edhe pse arsytimi i vendimeve është i qartë, i plotë dhe gjithëpërfshirës duke i dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve dhe kërkimeve të palëve ndërgjyqëse si në çështjet civile ashtu edhe në çështjet penale, nuk konstatohet një analizë e mirëfilltë ligjore e cila është pjesë e procesit logjik nëpërmjet të cilit gjyqtari ka arritur tek bindja e formuar. Kjo metodologji e punës së gjyqtarit, i bën vendimet gjyqësore të dominohen nga pjesa përshkruese e fakteve dhe analiza e provave, por jo në të njëjtën masë referuar analizës ligjore.

KONKLUZIONE

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se arsytimi i vendimeve gjyqësore realizohet mbi bazën e një zhvillimi logjik dhe të plotë në lidhje me rrethanat e çështjes konkrete, analizën e provave dhe përfaqsimin tyre me ligjin e zbatueshëm. Nga ana tjetër në asnjë prej vendimeve gjyqësore nuk evidentohet që gjyqtari të ketë zberthyer në mënyrë të pavarur normat ligjore relevante apo institutin përkatës së të drejtës, duke analizuar kuptimin, natyrën apo evidentuar kriteret ligjore të zbatimit të tij mbi faktet e provuara.

³² Vendimi nr. 190/1082, datë 08.04.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

³³ Vendimi nr. 93-1230, datë 19.04.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

³⁴ Vendimi nr. 126-615, datë 25.02.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet “Mbi mesataren”, duke u pikëzuar me 20 pikë. Ky konkluzion bazohet në analizën e metodologjisë së përgjithshme të punës së gjyqtarit në drejtim të këtij treguesi, duke analizuar të gjitha llojet e çështjeve të për zgjedhura, pa i dhënë peshë dhe rëndësi të veçantë asnjërës prej tyre.

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT	
Pikët	Niveli i vlerësimit
90	Shkëlqyeshëm

2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit në drejtim të aftësive organizative, vlerësuesi përqendrohet në aftësinë për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar efektivisht procedurat gjyqësore. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon sa mirë gjyqtari përdor kohën e tij si kur gjykon i vetëm ashtu edhe në panel me të tjerë.

2.A Aftësia e gjyqtarit për të përballuar ngarkesën në punë.

2.A.a Respektimi i afateve ligjore.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në raportin analitik, rezulton se çështjet në përgjithësi kanë përfunduar brenda afateve ligjore të parashikuara në K.Pr.Penale dhe K.Pr.Civile. Në total, referuar raportit të çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të afatit ligjor (51 çështje), me numrin total të çështjeve të gjykuara, për të cilat ligji procedural parashikon afat ligjor (237 çështje), rezulton që gjyqtari të ketë gjykuar 21.5 % të çështjeve jashtë afatit ligjor.

Konkretisht, rezulton të jenë gjykuar jashtë afatit ligjor çështjet si më poshtë vijon:

- (i) **3 (tre) çështje** me objekt “Kundërshtim veprimesh përmbare, për të cilat neni 610 paragrafi i tretë³⁵ i Kodit të Procedurës Civile, parashikon se çështja duhet të shqyrtohet brenda një afati 20 ditor, kanë përfunduar përkatësisht për

³⁵Neni 69 i ligjit nr. 49/2012 parashikon se “Veprimet e kryerja nga përmbareuesi gjyqësor, në kundërshtim me masat apo urdhrat e gjykatës, ankimohen sipas parashikimeve të nenit 610 të Kodit të Procedurës Civile.”. Ndërkohë neni 601 pg 3 i K.Pr.C parashikon se :”Ankimi shqyrtohet brenda 20 ditëve nga gjykata e vendit të ekzekutimit, e cila kur e sheh të nevojshme mund të thërrasë palët dhe përmbareuesin gjyqësor.”.

23 ditë, 2 muaj e 2 ditë dhe 22 ditë³⁶, duke tejaluar afatin ligjor përkatësisht me 3 ditë, 42 ditë dhe 2 ditë.

Në lidhje me afatin e gjykimit në çështjet me objekt “Kundërshtim veprimesh përmbaremore” neni 610 i Kodit të Procedurës Civile parashikon se ato shqyrtohen në dhomë këshillimi, dhe kur e vlerëson të arsyeshme, gjykata mund të thërrasë palët. Pavarësisht mënyrës së shqyrtimit, në dhomë këshillimi apo në seancë, gjykatës i duhet të kryejë disa veprime procedurale për të respektuar të drejtat e palëve në proces, duke kryer të paktën veprimet e mëposhtme:

- njoftimin e ankuesit për të plotësuar të metat e ankimit, nëse konstatohen të tilla dhe lënien e një afati të arsyeshëm deri 10 ditë sipas parashikimeve të nenit 154/a të K.Pr.C;
- caktimin e seancës dhe njoftimin e palëve për datën dhe orën e zhvillimit të gjykimit, duke respektuar një afat minimal për të mundësuar kryerjen e njoftimit prej 5 ditësh para seancës, nëse çështja do të shqyrtohet duke thirrur palët për t’u dëgjuar në seancë.

Vetëm me kryerjen e këtyre veprimeve minimale të domosdoshme për të respektuar të drejtat e palëve në proces, pa përlogaritur kohën e nevojshme për dërgimin e njoftimeve për plotësimin e të metave të padisë dhe për dërgimin e njoftimit për përmbareuesin gjyqësor për paraqitjen e provave, afati ligjor 20 ditor për përfundimin e gjykimit do të rezultonte i pamundur për tu respektuar. Ndërkohë që ligjvënësi, ndërsa për gjykatën e shkallës së parë që shqyrton ankimin në themel ka parashikuar afatin 20 ditor të shqyrtimit, për gjykatën e apelit që shqyrton ankimin ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë, mbi shkaqet e ankimit dhe kryesisht duke u bazuar në aktet e dosjes, ka parashikuar në nenin 610 një afat më të gjatë gjykimi prej 30 ditësh ose 45 ditësh, në rast se gjykata vlerëson të nevojshëm shqyrtimin e çështjes me praninë e palëve, kur janë rastet e parashikuara nga ligji.

Duke konsideruar sa më sipër, si dhe në mungesë të informacionit nëse tre çështjet e shqyrtuara jashtë afatit ligjor janë gjykuar në dhomë këshillimi apo në prezencë të palëve, çështjet për të cilat afati 20/ditor i gjykimit është tejkualuar me 3 dhe 2 ditë, do të konsiderohen të përfunduara brenda afatit ligjor, kjo duke konsideruar edhe mundësinë e përfshirjes së ditëve të pushimit javor gjatë afatit të gjykimit të çështjeve.

Sa më sipër, për çështjet me objekt “kundërshtim veprimesh përmbaremore”, do të konsiderohet e përfunduar në tejkualim të afatit ligjor vetëm 1 çështje gjykimi i së cilës ka tejkualuar afatin ligjor me 72 ditë ose 2 muaj e 12 ditë.

- (ii) **2 (dy) çështje** me objekt “Lëshim i urdhrat të mbrojtjes”, për të cilat neni 16, pika 1³⁷ i ligjit nr. 9669 datë 18.12.2006 i ndryshuar, parashikon afatin e gjykimit 15 ditë, kanë përfunduar përkatësisht për 19 dhe 24 ditë³⁸, duke tejkualuar afatin ligjor me 4 dhe 9 ditë.

³⁶ Në tabelën nr. 1, çështjet me nr. rendor 65 dhe 68, me objekt “Kundërshtim veprimesh përmbaremore”, kanë përfunduar përkatësisht për 23 ditë dhe 2 muaj e 2 ditë dhe në tabelën nr. 2, çështja me nr. rendor 21, me objekt “Kundërshtim veprimesh përmbaremore”, është gjykuar në afatin 22 ditë.

³⁷ Në nenin 16, pika 1 të ligjit nr. 9669 datë 18.12.2006, i ndryshuar parashikohet se :”1. Gjykata vendos për lëshimin e urdhrat të mbrojtjes brenda 15 ditëve nga dita e regjistrimit të kërkesës.”

³⁸ Në tabelën nr. 3, çështjet me nr. rendor 68 dhe 86, me objekt “Lëshim urdhrat mbrojtje”, të cilat janë gjykuar përkatësisht në afatin 19 dhe 24 ditë.

- (iii) **1 (një) çështje** me objekt “*Caktim përfaqësuesi ligjor*”, për të cilën neni 522 i K.Pr.C parashikon afatin 10 ditë të gjykimit, ka përfunduar për 1 muaj, duke tejkaluar me 20 ditë afatin ligjor të gjykimit³⁹.
- (iv) **1 (një) çështje** me objekt “*Miratim marrëveshje fajësie*”, e cila sipas nenit 406/dh të K.Pr.P duhet të përfundohet për 30 ditë, ka përfunduar për 2 muaj e 8 ditë duke tejkaluar me 1 muaj e 8 ditë afatin ligjor⁴⁰.
- (v) **3 (tre) çështje** me objekt “*Caktim mase sigurimi*”, për të cilat neni 244 në lidhje me nenin 260 të K.Pr.Penale parashikon afatin 5 ditor për shqyrtimin e kërkesës⁴¹ janë gjykuar nga 7 deri në 10 ditë. Referuar afatit ligjor 5 ditor për shqyrtimin e kërkesës, rezulton se këto 3 çështje janë shqyrtuar jashtë afatit, duke e tejkaluar atë më 5 ditë në dy çështje dhe 2 ditë në një çështje.
- (vi) **1 (një) çështje** me objekt “*Zëvendësim mase sigurimi*”, është gjykuar në afatin 7 ditë, ndërkohë që neni 260 i K. Pr. Penale ka parashikuar afatin ligjor të gjykimit 5 ditë, duke u tejkaluar ky afat me 2 ditë⁴².
- (vii) **2 (dy) çështje** me objekt “*Zgjatja e afatit të hetimit*”, janë gjykuar në afatin 14 dhe 17 ditë⁴³, ndërkohë që neni 325 i K. Pr. Penale ka parashikuar afatin ligjor të gjykimit 10 ditë, duke u tejkaluar ky afat me 4 dhe 7 ditë.
- (viii) **3 (tre) çështje** me objekt “*Kundërshtim i vendimit të prokurorit për mosfillimin e procedimit penal*”, të cilat janë gjykuar përkatësisht në afatin 2 muaj e 9 ditë, 1 muaj e 25 ditë dhe 1 muaj e 22 ditë, ndërkohë që neni 291 i K. Pr. Penale ka parashikuar afatin ligjor të gjykimit 30 ditë⁴⁴. Referuar të dhënave statistikore të analizuara në raportin analitik, rezulton se dy çështje, përkatësisht ato me nr. rendor 99 dhe 100 janë regjistruar në datë 16.07.2019 dhe 26.07.2019 dhe janë përfunduar përkatësisht më datë 11.09.2019 dhe 18.09.2019. Nëse nuk do të llogaritet periudha e lejes vjetore në muajin gusht prej 35 ditësh, atëherë këto çështje do të rezultojnë të gjykuara në afatin 20 dhe 17 ditë, pra në afat ligjor. **Për pasojë, për çështjet me objekt “Kundërshtim i vendimit të prokurorit për mosfillimin e procedimit penal”, do të konsiderohet e përfunduar tej afatit ligjor vetëm një çështje.**
- (ix) **30 (tridhjetë) çështje** me objekt “*Dërgim çështje në gjyq*”, janë gjykuar në tejkalim të afatit ligjor 30 ditë të parashikuar në nenin 332 të K.Pr.P, duke tejkaluar këtë afat nga 3 ditë deri në 4 muaj e 5 ditë maksimalisht⁴⁵. Referuar

³⁹ Në tabelën nr. 6, çështja me nr. rendor 2, me objekt “*Caktim përfaqësuesi ligjor*”, e cila është gjykuar në afatin 1 muaj.

⁴⁰ Në tabelën nr. 8, çështja me nr. rendor 57, me objekt “*Miratim marrëveshje fajësie*”, e cila është gjykuar në afatin 2 muaj e 8 ditë.

⁴¹ Në tabelën nr. 10, çështjet me nr. rendor 6, 19, 47, 57 dhe 59, me objekt “*Caktim mase sigurimi*”, të cilat janë gjykuar në afatin 3, 10, 10, 3 dhe 7 ditë.

⁴² Në tabelën nr. 10, çështja me nr. rendor 7, me objekt “*Zëvendësim mase sigurimi*”, e cila është gjykuar në afatin 7 ditë.

⁴³ Në tabelën nr. 10, çështjet me nr. rendor 95 dhe 98, me objekt “*Zgjatja e afatit të hetimit*”, të cilat janë gjykuar në afatin 14 dhe 17 ditë.

⁴⁴ Në tabelën nr. 10, çështjet me nr. rendor 97, 99 dhe 100, me objekt “*Kundërshtim i vendimit të prokurorit për mosfillimin e procedimit penal*”, të cilat janë gjykuar përkatësisht në afatin 2 muaj e 9 ditë, 1 muaj e 25 ditë dhe 1 muaj e 22 ditë.

⁴⁵ Në tabelën nr. 11, çështjet me nr. rendor 4, 9, 14, 15, 18, 22, 26, 27, 29, 38, 44, 51, 58, 77, 78, 93, 104, 107, 112, 115, 116, 121, 122, 124-126, 129, 131, 133 dhe 139 me objekt “*Dërgim çështje në gjyq*”, të cilat janë gjykuar përkatësisht në afatet 5 muaj e 5 ditë, 4 muaj e 20 ditë, 1 muaj e 10 ditë, 1 muaj e 17 ditë, 1 muaj e 10 ditë, 1 muaj e 6 ditë, 2 muaj e 8 ditë, 1 muaj e 6 ditë, 2 muaj e 16 ditë, 1 muaj e 8 ditë, 2 muaj e 27 ditë, 2 muaj e 1 ditë, 10 muaj e 8 ditë, 1 muaj e 26 ditë, 1 muaj e 3 ditë, 1 muaj e 11 ditë, 4 muaj e 6 ditë, 2 muaj e 7 ditë, 4 muaj e 10 ditë, 1 muaj e 29 ditë, 3 muaj e 1 ditë, 1 muaj e 25 ditë, 1 muaj e 18 ditë, 1 muaj e 5 ditë, 1 muaj e 6 ditë, 1 muaj e 14 ditë, 1 muaj e 13 ditë, 2 muaj e 29 ditë, 2 muaj e 13 ditë dhe 1 muaj e 7 ditë.

të dhënave statistikore të analizuara në raportin analitik, rezulton se çështjet me nr. rendor 115, 121, 122 janë regjistruar përkatësisht më datë 22.07.2019, 31.07.2019 dhe 31.07.2019 dhe janë përfunduar përkatësisht më datë 11.09.2019, 25.09.2019 dhe 18.09.2019. Nëse nuk do të llogaritet periudha e lejes vjetore në muajin gusht prej 35 ditë, atëherë këto çështje do të rezultojnë të gjykuara në afatin 24, 20 dhe 17 ditë, pra në afat ligjor. **Për pasojë, për çështjet me objekt “Dërgimin e çështjes në gjyq”, do të konsiderohen të përfunduara te j afatit ligjor 27 çështje.**

- (x) **3 (tre)** çështje me objekt “*Kundër vendimit të pushimit të hetimeve*”, janë gjykuar përkatësisht në afatet 22 ditë, 1 muaj e 7 ditë dhe 1 muaj e 3 ditë, ndërkohë që neni 329 i K. Pr. Penale ka parashikuar afatin ligjor të gjykimit 15 ditë, duke u tejkualuar ky afat përkatësisht me 7 ditë, 22 ditë dhe 18 ditë⁴⁶.

Referuar analizës së mësipërme, edhe pse efektivisht rezulton që gjyqtari të ketë gjykuar 42 çështje ose 17.7 % të çështjeve, jashtë afatit ligjor, kjo përqindje, referuar metodologjisë, përkon me nivelin e pikëzimit 12 pikë.

Gjyqtari në Formularin e Integruar të Vlerësimit e ka vlerësuar treguesin “*Respektimi i afateve ligjore*” në shkallë shumë të lartë duke argumentuar si vijon: “*Për vitin 2019 kam përfunduar 848 çështje, rreth 4 herë më shumë se norma, duke punuar në kushte jo normale për disa muaj për shkak të tërmetit të muajit nëntor 2019, dhe kam arritur të ruaj afatet e gjykimit, arsytimit dhe dorëzimit të vendimeve. Këto të dhëna janë tregues i një aftësie shumë të mirë organizative.*”.

Në mendimin e tij Kryetari i Gjykatës në lidhje me këtë tregues është shprehur : “*Gjyqtari ka treguar aftësi për respektimin e afateve të parashikuara nga ligji brenda të cilave duhet të përfundojë gjykimi i çështjeve. Në këtë aspekt duhet të konsiderohet ngarkesa e lartë me çështje.*”.

KONKLUZIONE

Nëse do të bënim vetëm një analizë matematikore të të dhënave statistikore, referuar Metodologjisë, përqindja e rezultuar (17.7 %) përkon me pikëzimin me 12 pikë. Por analiza e të dhënave statistikore nuk bëhet nga vlerësuesi në mënyrë matematikore, por është një analizë logjike e të dhënave burimore. Referuar ngarkesës së gjyqtarit si relator (në total ka gjykuar 821 çështje), mendimit të kryetarit dhe vetëvlerësimit të gjyqtarit; numrit të çështjeve me afat ligjor ku gjyqtari ka qenë relator i cili rezulton i konsiderueshëm (237 çështje ose 29 % e numrit total të çështjeve të përfunduara), si dhe kushteve të punës referuar ngjarjeve natyrore në vitin 2019, vlerësohet se gjyqtari duhet të ketë rritje me një shkallë pikëzimi për këtë tregues, nga 12 me 15 pikë.

⁴⁶ Në tabelën nr. 11, çështjet me nr. rendor 145, 146 dhe 148, me objekt “*Kundër vendimit të pushimit të hetimeve*”, të cilat janë gjykuar përkatësisht në afatet 22 ditë, 1 muaj e 7 ditë dhe 1 muaj e 3 ditë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me këtë tregues, gjyqtari pikëzohet me 15 pikë, pasi pavarësisht se përqindja e çështjeve të gjykuara jashtë afatit ligjor është 17.7 %, ngarkesa e gjyqtarit si relator ka qenë tejet e lartë dhe numri i çështjeve me afat ligjor i konsiderueshëm.

2.A.b Plotësimi i standardeve minimale kohore.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në raportin analitik, rezulton se: Gjyqtari subjekt vlerësimi, ka gjykuar në total 583 çështje për të cilat parashikohet standard minimal kohor (pa përfshirë këtu çështjet për të cilat parashikohen afate gjykimi) nga të cilat 94 çështje jashtë këtij afati. Konkretisht, rezulton të jenë gjykuar jashtë afatit standard minimal kohor çështjet sipas kategorive, si më poshtë:

- (i) 15 (pesëmbëdhjetë) çështje tek tabela nr. 1 e kategorisë “*civile të përgjithshme me palë kundërshtare*”⁴⁷, të cilat kanë përfunduar jashtë afatit 6 (gjashtë) muajor të parashikuar nga pika 5/e, e aneksit 1, të vendimit nr. 261/2, datë 14.04.2010 të KLD-së. Nga këto çështje, një prej tyre, rezulton të ketë tejkaluar afatin 6/muajor me vetëm 3 ditë, tejkallim i cili konsiderohet i papërfillshëm dhe për pasojë, **numri i çështjeve të gjykuara tej afatit standard për këtë kategori rezulton të jetë 14 çështje.**
- (ii) 23 (njëzet e tre) çështje tek tabela nr. 2 e kategorisë “*civile të përgjithshme pa palë kundërshtare*”⁴⁸, të cilat kanë përfunduar jashtë afatit 2 (dy) muajor të parashikuar nga pika 5/j, e aneksit 1, të vendimit nr. 261/2, datë 14.04.2010 të KLD-së. Nga këto çështje, një prej tyre⁴⁹, rezulton të ketë tejkaluar afatin 2/muajor me vetëm 2 ditë, tejkallim i cili konsiderohet i papërfillshëm dhe për pasojë, **numri i çështjeve të gjykuara tej afatit standard për këtë kategori rezulton të jetë 22 çështje.**
- (iii) 25 (njëzet e pesë) çështje tek tabela nr. 3 e kategorisë “*familjare me palë kundërshtare*”⁵⁰, të cilat kanë përfunduar jashtë afatit 4 (katër) muajor të parashikuar nga pika 5/d, e aneksit 1, të vendimit nr. 261/2, datë 14.04.2010 të KLD-së. Nga këto çështje, dy prej tyre⁵¹, rezulton të ketë tejkaluar afatin

⁴⁷ Në tabelën nr. 1, çështjet me nr. rendor 1, 4-7, 10-12, 23, 24, 26, 34, 39 dhe 71, janë gjykuar përkatësisht në afatin 2 vjet 8 muaj e 2 ditë, 11 muaj e 22 ditë, 7 muaj e 11 ditë, 11 muaj e 29 ditë, 7 muaj e 2 ditë, 6 muaj e 3 ditë, 7 muaj e 23 ditë, 9 muaj e 13 ditë, 1 vit 1 muaj e 28 ditë, 3 vjet 1 muaj e 13 ditë, 6 muaj e 27 ditë, 1 vit 7 muaj e 13 ditë, 9 muaj e 18 ditë, 1 vit 1 muaj e 11 ditë

⁴⁸ Në tabelën nr. 2, çështjet me nr. rendor 2-5, 7, 9-16, 18-20, 22-28 dhe 32, janë gjykuar përkatësisht në afatin 10 muaj e 5 ditë, 3 muaj e 13 ditë, 2 muaj e 13 ditë, 3 muaj e 4 ditë, 2 muaj e 23 ditë, 2 muaj e 15 ditë, 2 muaj e 8 ditë, 3 muaj e 5 ditë, 2 muaj e 20 ditë, 2 muaj e 2 ditë, 3 muaj e 1 ditë, 3 muaj e 19 ditë, 2 muaj e 9 ditë, 2 muaj e 7 ditë, 2 muaj e 8 ditë, 3 muaj e 20 ditë, 3 muaj e 29 ditë, 3 muaj e 1 ditë, 3 muaj e 20 ditë, 3 muaj e 12 ditë, 2 muaj e 29 ditë, 2 muaj e 17 ditë, 2 muaj e 27 ditë, 2 muaj e 11 ditë.

⁴⁹ Çështja me numër rendor 13, në tabelën nr.2.

⁵⁰ Në tabelën nr. 3, çështjet me nr. rendor 1-3, 5, 8-10, 12-14, 21, 24, 31, 33, 36, 39, 40, 42, 47, 49, 50, 53, 54, 59, 61 dhe 63, të cilat janë gjykuar përkatësisht në afatin 4 muaj e 28 ditë, 4 muaj e 28 ditë, 4 muaj e 17 ditë, 8 muaj e 2 ditë, 4 muaj e 25 ditë, 4 muaj e 11 ditë, 9 muaj e 5 ditë, 4 muaj e 24 ditë, 4 muaj e 4 ditë, 4 muaj e 13 ditë, 5 muaj e 23 ditë, 5 muaj e 10 ditë, 6 muaj e 20 ditë, 5 muaj e 21 ditë, 4 muaj e 17 ditë, 4 muaj e 12 ditë, 5 muaj e 28 ditë, 6 muaj e 10 ditë, 4 muaj e 8 ditë, 5 muaj, 5 muaj, 5 muaj e 3 ditë, 4 muaj e 22 ditë, 4 muaj e 5 ditë, 4 muaj e 12 ditë, 4 muaj e 11 ditë.

⁵¹ Çështja me numër rendor 13, në tabelën nr.2.

4/mujor me vetëm 4 dhe 5 ditë⁵², tejkalim i cili konsiderohet i papërfillshëm dhe për pasojë, **numri i çështjeve të gjykuara tej afatit standard për këtë kategori rezulton të jetë 23 çështje.**

- (iv) 2 (dy) çështje tek tabela nr. 8 e kategorisë “*penale krime*”⁵³, të cilat kanë përfunduar jashtë afatit 9 (nëntë) mujor të parashikuar nga pika 5/a, e aneksit 1, të vendimit nr. 261/2, datë 14.04.2010 të KLD-së.
- (v) 1 (një) çështje tek tabela nr. 9 e kategorisë “*penale kundërvajtje*”⁵⁴, e cila ka përfunduar tej afatit 4 (katër) mujor të parashikuar nga pika 5/a, e aneksit 1, të vendimit nr. 261/2, datë 14.04.2010 të KLD-së.
- (vi) 11 (njëmbëdhjetë) çështje tek tabela nr. 11, e kategorisë “*penale seancë paraprake*”⁵⁵, të cilat kanë përfunduar jashtë afatit 2 (dy) mujor të parashikuar nga pika 5/j, e aneksit 1, të vendimit nr. 261/2, datë 14.04.2010 të KLD-së. Nga këto çështje, një prej tyre⁵⁶, rezulton të ketë tejkaluar afatin 2/mujor me vetëm 1 ditë, tejkalim i cili konsiderohet i papërfillshëm dhe për pasojë, **numri i çështjeve të gjykuara tej afatit standard për këtë kategori rezulton të jetë 10 çështje.**
- (vii) 17 (shtatëmbëdhjetë) çështje tek tabela nr. 12, e kategorisë “*çështje penale të fazës së ekzekutimit dhe marrëdhënieve juridiksionale me jashtë*”⁵⁷, të cilat kanë përfunduar jashtë afatit 2 (dy) mujor të parashikuar nga pika 5/j, e aneksit 1, të vendimit nr. 261/2, datë 14.04.2010 të KLD-së. Nga këto çështje, dy prej tyre⁵⁸, rezulton të kenë tejkaluar afatin 2/mujor me vetëm 2 dhe 4 ditë, tejkalim i cili konsiderohet i papërfillshëm dhe për pasojë, **numri i çështjeve të gjykuara tej afatit standard për këtë kategori rezulton të jetë 15 çështje.**

Sa më sipër, rezulton se gjyqtari {...} ka përfunduar tej standardit minimal kohor 87 çështje, të cilat përbëjnë 14.9 % të çështjeve jashtë afatit standard minimal kohor.

Gjyqtari në Formularin e Integruar të Vlerësimit e ka vlerësuar treguesin “*Plotësimi i standardeve minimale kohore*” në shkallë shumë të lartë duke argumentuar se ka përfunduar një numër shumë të lartë çështjesh. I njëjti vlerësim është bërë edhe nga Kryetari i Gjykatës.

Pikëzimi për këtë tregues përcaktohet duke iu referuar raportit të çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të standardit minimal kohor me numrin total të çështjeve të gjykuara për të cilat ligji nuk parashikon afat ligjor gjykimi. Referuar raportit të çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të standardit minimal kohor (87 çështje), me numrin total të çështjeve të gjykuara, pa përfshirë çështjet për të cilat parashikohen në ligj afate

⁵² Çështjet me numër rendor 13 dhe 59, në tabelën nr. 3.

⁵³ Në tabelën nr. 8, çështjet me nr. rendor 8 dhe 15, janë gjykuar përkatësisht në afatin 9 muaj e 12 ditë dhe 9 muaj e 19 ditë.

⁵⁴ Në tabelën nr. 9, çështja me nr. rendor 2, është gjykuar në afatin 1 vit 3 muaj e 25 ditë.

⁵⁵ Në tabelën nr. 11, çështjet me nr. rendor 28, 30, 92, 102, 103, 109, 113, 118-120 dhe 135 janë gjykuar përkatësisht në afatin 2 muaj e 15 ditë, 2 muaj e 10 ditë, 3 muaj e 13 ditë, 2 muaj e 20 ditë, 2 muaj e 22 ditë, 2 muaj e 24 ditë, 2 muaj e 1 ditë, 2 muaj e 17 ditë, 2 muaj e 8 ditë, 2 muaj e 14 ditë, 2 muaj e 8 ditë.

⁵⁶ Çështja me numër rendor 113, në tabelën nr.11.

⁵⁷ Në tabelën nr. 12, çështjet me nr. rendor 2, 3, 8, 10, 13, 19, 21, 25, 27-31, 33, 37, 46, 78 janë gjykuar përkatësisht në afatin 3 muaj e 15 ditë, 6 muaj e 17 ditë, 2 muaj e 6 ditë, 2 muaj e 11 ditë, 2 muaj e 17 ditë, 4 muaj e 27 ditë, 3 muaj e 18 ditë, 2 muaj e 17 ditë, 2 muaj e 6 ditë, 2 muaj e 4 ditë, 2 muaj e 9 ditë, 2 muaj e 7 ditë, 2 muaj e 27 ditë, 10 muaj e 5 ditë, 2 muaj e 2 ditë, 3 muaj e 25 ditë dhe 4 muaj e 9 ditë.

⁵⁸ Çështjet me numër rendor 28 dhe 43, në tabelën nr.12.

gjkimi (583 çështje), gjyqtari rezulton që të ketë gjykuar 14.9 % të çështjeve në tejkallim të standardit minimal kohor, përqindje e cila pikëzohet me 4 pikë.

Referuar Metodologjisë, të dhënat statistikore analizohen, duke shmangur çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Vlerësuesi mund të përcaktojë një shkallë më të lartë pikëzimi duke marrë parasysh tregues të tjerë që lidhen me produktivitetin e gjyqtarit, siç është në rastin konkret, treguesi sasior i punës së gjyqtarit i cili rezulton se ka përfunduar në total 821 çështje, nga të cilat 380 çështje me palë kundërshtare (*civile të përgjithshme, familjare, marrëdhënie pune, penale krime, penale kundërvajtje dhe çështje penale seancë paraprake*). Referuar standardit sasior në fuqi⁵⁹, gjyqtari duhet të përfundonte jo më pak se 200 çështje me palë kundërshtare në vit. Ndërkohë rezulton se ai ka përfunduar 380 çështje me palë kundërshtare, duke tejkalluar këtë standard me 180 çështje në vit ose në masën 90 %. Nga ana tjetër gjyqtari ka përfunduar edhe 441 çështje të tjera pa palë kundërshtare.

KONKLUZIONE

Për sa më sipër, për pikëzimin e këtij treguesi, duke iu referuar analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit lidhur me : (i) raportin e çështjeve të gjykuara tej standardit me numrin total të çështjeve që rezulton 14.9 % dhe (ii) tejkallimin e standardit sasior të zbatueshëm në masën 90 %, vlerësohet se për këtë tregues gjyqtari duhet të pikëzohet në nivelin maksimal.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, vlerësohet se në lidhje me këtë tregues, gjyqtari pikëzohet me 5 pikë, pasi pavarësisht se përqindja e çështjeve të gjykuara jashtë afatit standard minimal kohor është 14.9, ngarkesa e gjyqtarit ka qene shumë e lartë dhe ai ka tejkalluar standardin sasior në fuqi me 90 % të çështjeve me palë kundërshtare, mbi këtë standard.

2.A.c Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në raportin analitik, rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështje, krahasuar me standardin minimal kohor në fuqi sipas vendimit nr. 261/2, datë 14.4.2010 të KLD-së, pa përfshirë çështjet për të cilat ligji parashikon afate gjykimi, është më e shkurtër se standardi për të gjitha kategoritë e çështjeve, me përjashtim të kategorisë “*Kundërvajtje*”, për të cilën koha mesatare rezulton të jetë më e gjatë⁶⁰.

Konkretisht, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje për kategori, rezulton si më poshtë:

⁵⁹ Në vendimin nr. 261/2, viti 2010, t ish KLD-së, lidhur me standardin sasior, në pikën 3, shkronja g), parashikohet se “*Gjyqtari i gjykatës së shkallës së parë që nuk është i organizuar në seksione, si relator, jo më pak se 200 çështje penale (krime dhe kundërvajtje) dhe civile që kanë të bëjnë me mosmarrëveshje me palë kundërshtare.*”.

⁶⁰ Për çështjet e kategorisë “*Kundërvajtje*”, koha mesatare rezulton të jetë 146 ditë ose 4 muaj e 26 ditë, ndërkohë që standardi minimal kohor i miratuar sipas vendimit nr. 261/2, datë 14.4.2010 të KLD-së rezulton të jetë katër muaj.

- (i) Në çështjet e kategorisë “*civile të përgjithshme pa palë kundërshtare*” koha mesatare që i dedikohet çdo çështje rezulton të jetë 171 ditë (5 muaj e 21 ditë), pra **më e shkurtër** se afati standard minimal kohor i miratuar prej 6 (gjashtë) muajsh ;
- (ii) Në çështjet e kategorisë “*civile të përgjithshme pa palë kundërshtare*”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje rezulton të jetë 17 ditë, pra **më e shkurtër** se afati standard minimal kohor i miratuar prej 2 (dy) muajsh;
- (iii) Në çështjet e kategorisë “*familjare me palë kundërshtare*”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje rezulton të jetë 114 ditë (3 muaj e 24 ditë), pra **më e shkurtër** se afati standard minimal kohor i miratuar prej 4 (katër) muajsh;
- (iv) Në çështjet e kategorisë “*familjare pa palë kundërshtare*”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje rezulton të jetë 37 ditë (1 muaj e 7 ditë), pra **më e shkurtër** se afati standard minimal kohor i miratuar prej 2 (dy) muajsh;
- (v) Në çështjet e kategorisë “*tregtare me palë kundërshtare*”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje rezulton të jetë 44 ditë (1 muaj e 4 ditë), pra **më e shkurtër** se afati standard minimal kohor i miratuar prej 6 (gjashtë) muajsh;
- (vi) Në çështjet e kategorisë “*marrëdhënie pune*”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje rezulton të jetë 120 ditë (3 muaj), pra **më e shkurtër** se afati standard minimal kohor i miratuar prej 6 (gjashtë) muajsh;
- (vii) Në çështjet e kategorisë “*penale krime*”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje rezulton të jetë 66 ditë (2 muaj e 6 ditë) pra **më e shkurtër** se afati standard minimal kohor i miratuar prej 9 (nëntë) ose 12 (dymbëdhjetë) muajsh;
- (viii) Në çështjet e kategorisë “*penale kundërvajtje*”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje rezulton të jetë 146 ditë (4 muaj e 26 ditë), pra **më e gjatë** se afati standard minimal kohor i miratuar prej 4 (katër) muajsh;
- (ix) Në çështjet e kategorisë “*kërkesa penale të fazës së hetimit paraprak*”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje rezulton të jetë 10 ditë, pra **më e shkurtër** se afati standard minimal kohor i miratuar prej 2 (dy) muajsh;
- (x) Në çështjet e kategorisë “*seancë paraprake*”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje rezulton të jetë 35 ditë (1 muaj e 5 ditë), pra **më e shkurtër** se afati standard minimal kohor i miratuar prej 2 (dy) muajsh;
- (xi) Në çështjet e kategorisë “*kërkesa penale gjatë fazës së ekzekutimit dhe marrëdhënieve juridiksionale me jashtë*”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje rezulton të jetë 40 ditë (1 muaj e 10 ditë) , pra **më e shkurtër** se afati standard minimal kohor i miratuar prej 2 (dy) muajsh;

Gjyqtari në Formularin e Integruar të Vlerësimit e ka vlerësuar treguesin “*Koha mesatare që i dedikohet çdo çështje*” në shkallë mbi mesataren duke e argumentuar me ngarkesën në punë dhe faktorë të tjerë si mungesa e palëve apo dëshmitarëve. Ndërkohë që Kryetari e ka vlerësuar këtë shkallë aftësie shumë të lartë.

Në Metodologjinë e Pikëzimit parashikohet se për të bërë pikëzimin e këtij treguesi, të dhënat statistikore analizohen sipas situatës për të shmangur përfundimet që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit⁶¹. Referuar metodologjisë, duke qenë se nga 11 kategori çështjesh,

⁶¹Metodologjia e Pikëzimit për këtë tregues parashikon se :”... Të gjitha të dhënat statistikore analizohen sipas situatës, me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Analiza e të dhënave statistikore bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të

vetëm për një prej tyre koha mesatare tejkalon standardin minimal kohor, gjyqtari duhej të pikëzohej me 4 pikë. Por vlerësuesi merr parasysh në pikëzim situatën konkrete, duke shmangur çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Nga analiza e të dhënave të pasqyruara në Raportin Analitik rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është **më e gjatë** se standardi minimal kohor i miratuar prej për vetëm 1 nga 11 kategoritë e çështjeve, duke u tejkeluar koha mesatare përkatësisht me 26 ditë.

Po ashtu, në pikëzimin e këtij treguesi, duke shmangur çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit, vlerësuesi mund të përcaktojë një shkallë më të lartë pikëzimi duke marrë parasysh tregues të tjerë që lidhen me produktivitetin e gjyqtarit, siç është në rastin konkret, treguesi sasior i punës pasi rezulton se gjyqtari ka përfunduar këtë vit kalendarik në total 821 çështje, nga të cilat 380 çështje me palë kundërshtarë , duke tejkeluar këtë standardin sasior në fuqi me 180 çështje në vit ose në masën 90 %.

KONKLUZIONE

Në tërësi, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga analiza e integruar burimeve të vlerësimit, si dhe krahasimit të kohës mesatare që i dedikohet çdo çështje për të gjitha kategoritë, me standardin minimal kohor në fuqi për kategori çështjes, rezulton se koha mesatare që i dedikohet është më e shkurtër se ky afat për 10 nga 11 kategoritë e çështjeve. Koha mesatare është më e gjatë se standardi vetëm për 1 nga kategoritë e çështjeve, ndërkohë që gjyqtari ka përballuar një ngarkesë të lartë duke tejkeluar këtë standardin sasior në fuqi me 180 çështje themeli në vit ose në masën 90 %. Për këto arsye vlerësohet se për këtë tregues gjyqtari duhet të pikëzohet në nivelin maksimal.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: *Referuar sa më sipër, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje konsiderohet më e shkurtër ose e barabartë me standardin minimal kohor për të gjitha kategoritë e çështjeve, prandaj në lidhje me këtë tregues gjyqtari pikëzohet me 5 pikë.*

2.A.ç Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në raportin analitik, rezulton se gjyqtari ka përfunduar si relator 821 çështje, ndërkohë që i janë caktuar në këtë cilësi gjithsej 680 çështje. Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore nga gjyqtari për periudhën e vlerësimit në total është 120 %.

Gjyqtari në Formularin e Integruar të Vlerësimit e ka vlerësuar treguesin “Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore” në shkallë mbi mesataren duke argumentuar se për vitin 2019 ka përfunduar mbi 90% të çështjeve që ka pasur në gjykim, pavarësisht ngarkesës në punë.

KONKLUZIONE

Duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore nga gjyqtari për periudhën e vlerësimit është 120 %, pra “+99%” dhe si i tillë vlerësohet me 10 pikë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, është “+99%”, duke u pikëzuar me 10 pikë.

2.A.d Koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar gjyqësor.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në raportin analitik, rezulton se koha mesatare e arsytimit të vendimeve gjyqësore për kategori çështjesh, krahasuar me afatin procedural të parashikuar në ligj, është më e shkurtër, për shumicën e kategorive të çështjeve. Kështu, koha mesatare e arsytimit të vendimeve gjyqësore rezulton të jetë më e gjatë se afati ligjor i parashikuar për çështje të kategorive “*kërkesa penale të hetimit paraprak*” dhe “*kërkesa penale të fazës së ekzekutimit dhe marrëdhënieve juridiksionale me jashtë*”, si më poshtë:

- Për çështje të kategorisë “*kërkesa penale të hetimit paraprak*” me objekt caktim mase sigurimi, koha mesatare e arsytimit është 1, 5 ditë, pra më e gjatë se afati procedural i parashikuar nga neni 244/1 i K. Pr. Penale, i cili kërkon që vendimi të jepet i arsytuar.
- Për çështje të kategorisë “*kërkesa penale të hetimit paraprak*” me objekt verifikim i kushteve të zbatimit të masës së sigurimit, koha mesatare e arsytimit është 4 ditë, pra më e gjatë se afati procedural 48 orë i parashikuar nga neni 248, pika 2 i K. Pr. Penale.
- Për çështje të kategorisë “*kërkesa penale të hetimit paraprak*” me objekt shuarje mase sigurimi, koha mesatare e arsytimit është 11 ditë, pra më e gjatë se afati procedural 48 orë i parashikuar nga neni 261/3 dhe 248/2 i K. Penal.
- Për çështje të kategorisë “*kërkesa penale të hetimit paraprak*” me objekt lejim përgjimi, koha mesatare e arsytimit është 16 ditë, pra më gjatë se afati procedural 24 orë i parashikuar nga neni 222 i K. Pr. Penale.
- Për çështje të kategorisë “*kërkesa penale të hetimit paraprak*” me objekt kontroll banese, koha mesatare e arsytimit është 4 ditë, pra më gjatë se afati procedural i parashikuar nga neni 202/a i K. Pr. Penale, i cili kërkon që vendimi të jepet i arsytuar.
- Për çështje të kategorisë “*kërkesa penale të fazës së ekzekutimit dhe marrëdhënieve juridiksionale me jashtë*” me objekt shtyrje e ekzekutimit të vendimit, koha mesatare e arsytimit është 10 ditë, pra më e gjatë se afati procedural 5 ditë i parashikuar nga neni 476 , pika 3 i K. Pr. Penale.

Gjyqtari në Formularin e Integruar të Vlerësimit e ka vlerësuar treguesin “*Koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar gjyqësor*” në shkallë shumë të lartë duke argumentuar se të gjitha vendimet janë arsytuar dhe dorëzuar brenda afateve të parashikuara në ligj. ***Kryetari***

i Gjykatës e ka vlerësuar *shumë të lartë* aftësinë e gjyqtarit për të arsyetuar në kohë vendimet gjyqësore.

KONKLUZIONE

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se koha mesatare e arsyetimit të vendimeve gjyqësore është më e shkurtër se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve, konkretisht për 9 nga 11 kategori çështjesh, e cila sipas Metodologjise përkon me një pikëzim prej 12 pikësh. Por vlerësuesi vlerëson rezultatet e analizës matematikore të të dhënave statistikore sipas një analize logjike të tyre, duke evituar shkaqe që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Gjithsesi ato nuk mund të çojnë në një pikëzim më të lartë, se rritja me një shkallë që i përgjigjet sipas metodologjisë, koeficientit 20%. Prandaj duke marrë në konsideratë kategoritë si më sipër dhe kohën e kësaj vonese (vetëm me disa ditë), në disa raste e papërfillshme, përballë numrit të lartë të vendimeve të arsyetuara brenda 1 viti kalendarik, në total 821 vendime, vlerësohet se është rasti i përcaktimit të një niveli më të lartë vlerësimi se ai që përkon vetëm me analizën matematikore.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër, për këtë kriter gjyqtari pikëzohet me 15 pikë, pasi edhe pse “koha mesatare e arsyetimit të vendimit gjyqësor përfundimtar” është tejkaluar për dy nga kategoritë e çështjeve, zbatimi i koeficientit 20% sipas metodologjisë dhe ngarkesa e punës së gjyqtarit, mundëson rritjen e pikëzimit me 1 shkallë.

2.B Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore.

2.B.a Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproduktive.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në raportin analitik rezulton se numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh (përfjashtuar ato pa palë ndërgjyqëse) është si më poshtë vijon:

- Për çështje të kategorisë “*civile të përgjithshme me palë kundërshtare*” është 4, 7.
- Për çështje të kategorisë “*familjare me palë kundërshtare*” është 1, 7.
- Për çështje të kategorisë “*marrëdhënie pune*” është 2, 8.
- Për çështje të kategorisë “*krime*” është 4, 3.
- Për çështje të kategorisë “*kundërvajtje*” është 5, 6.
- Për çështje të kategorisë “*seancë paraprake*” është 2.

Në total, numri mesatar i seancave gjyqësore për të gjitha kategoritë e çështjeve është 3, 2.

Sa i përket kryerjes së veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproduktive, duke iu referuar raportit analitik dhe akteve të dosjeve të përzgjedhura me short, rezulton se:

- Gjyqtari ka mbikëqyrur si duhet procedurën e kryerjes së njoftimeve duke verifikuar se njoftimet janë të plota dhe të qarta për palët që iu drejtohen, si dhe janë dërguar pa vonesë.
- Përgjithësisht, shtyrjet e seancave gjyqësore kanë ndodhur për shkaqe objektive si: kryerjen e njoftimit me shpallje; përsëritjen e njoftimit në rastin e mosrealizimit të tij; mungesës së palëve; shpalljen e vendimit etj.
- Në rastet kur seanca është shtyrë për shkak të mungesës së pajustificuar të prokurorit, gjyqtari ka proceduar me njoftimin e drejtuesit përkatës të Prokurorisë, në zbatim të nenit 348/3 të K. Pr. Penale.
- Në rastet kur shtyrja e seancave është realizuar për mosparaqitje të mbrojtësve pa shkaqe të arsyeshme, gjyqtari ka proceduar me gjobitjen e tyre.
- Në rastet kur ka rezultuar i pamundur njoftimi i dëshmitarëve përmes fletëthirrjes, gjykata ka kërkuar njoftimin përmes policisë gjyqësore, si dhe ka verifikuar vendndodhjen momentale brenda apo jashtë kufirit të Republikës së Shqipërisë.
- Në rastet e mosparaqitjes së dëshmitarëve me gjithë dijeninë e rregullt të tyre dhe pa asnjë shkak të arsyeshëm, gjykata ka urdhëruar shoqërimin e detyrueshëm.
- Përgjithësisht, seancat gjyqësore janë shtyrë brenda një afati në maksimum prej 20 - 30 ditësh nga njëra – tjetra në çështjet civile/familjare dhe deri në 14 ditë konform nenit 342/2 të K.Pr.Penale në çështjet penale. Përrjashtimisht, konstatohet lënia në një kohë të gjatë e seancës për shkak të lejes vjetore ne muajin Gusht.

KONKLUZIONE

Referuar sa më sipër, për treguesin e “*numrit mesatar të seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive*”, duke iu referuar të dhënave statistikore të çështjeve me palë kundërshtare, rezulton se numri mesatar i seancave gjyqësore është 3.2 seanca dhe gjyqtari në përgjithësi ka marrë masat e nevojshme për shmangien e seancave jo produktive, planifikimin dhe zhvillimin në kohë dhe me efektivitet të tyre, prandaj gjyqtari duhet të vlerësohet me 15 pikë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “*numri mesatar i seancave për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive*” gjyqtari pikëzohet me 15 pikë, pasi numri mesatar i seancave gjyqësore në dosjet e analizuara është 3.2 seanca dhe në përgjithësi gjyqtari ka treguar shkallë të lartë aftësie në shmangien e seancave joproduktive.

2.B.b Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në raportin analitik, rezulton se, gjyqtari në përgjithësi ka vënë në lëvizje çështjet duke marrë vendim për caktimin e seancës përgatitore dhe/ose gjyqësore, pas caktimit të çështjes me short, duke iu referuar rregullave dhe gjykimit sipas kategorive të çështjeve. Konkretisht në çështjet civile gjyqtari ka

disponuar me vendim si për njoftimin e akteve dhe kërkesë padisë palëve të paditura konform nenit 158 të K.Pr.Civile në funksion të lëshimit të deklaratës së mbrojtjes, por njëkohësisht edhe për kalimin e çështjes në seancë përgatitore/pajtimi (*neni 158/b,ç i K.Pr.Civile*) e në vijim pas ezaurimit të seancës përgatitore/pajtimit, me nxjerrjen e urdhrin për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore (*neni 158/c të K.Pr.Civile*). Në çështjet penale, konstatohet se gjithmonë gjyqtari ka vënë dosjen në lëvizje brenda 5 ditëve sikundër parashikohet në nenin 332/1 të K.Pr.Penale për çështjet e kategorisë seancë paraprake me objekt dërgimin e çështjes në gjyq, ndërkohë në çështjet penale të themelit në respektim të nenit 333/1 të K.Pr.Penale.

Në çështjet e përzgjedhura me short, gjyqtari jo vetëm i ka vënë në lëvizje dosjet në kohë dhe në përputhje me kërkesat dhe afatet ligjore duke caktuar seancën, por ka treguar edhe kujdes maksimal për marrjen e masave për njoftimin e palëve me qëllim zhvillimin e seancave gjyqësore efektive. Gjithashtu, rezulton se të gjitha veprimet procedurale gjatë shqyrtimit gjyqësor janë të dokumentuara. Drejtimi i procesit gjyqësor ka qenë i rregullt sipas kërkesave procedurale të parashikuara në ligj për gjykimin në shkallë të parë si në çështjet civile (*nenet 171 e vijues të K.Pr.Civile*) ashtu edhe në çështjet penale (*nenet 341 e vijues të K.Pr.Penale*) apo sipas ritit të gjykimeve të seancave paraprake (*neni 332/c i K.Pr.Penale i ndryshuar me ligjin nr. 35/2017*).

Gjatë zhvillimit të gjykimit, gjyqtari tregon kujdes të posaçëm për verifikimin e paraqitjes së palëve, mbrojtësve, relativin e akteve të njoftimit të tyre, shkaqeve të mosparaqitjes së palëve ose pjesëmarrësve, marrjen e mendimit të palëve në çdo rast lidhur me ecurinë e gjykimit, zhvillimin e gjykimit në mungesë të të pandehurit apo të paditurve, shpalljen e gjykatës, dëgjimin e kërkesave paraprake të palëve, shqyrtimin dhe vendimmarrjen e arsyetuar të gjykatës mbi këto kërkesa, zhvillimin e shqyrtimit gjyqësor sipas llojit të procesit të zhvilluar, dhënien e fjalës palëve për parashtrimin dhe paraqitjen e fakteve dhe të provave, shtyrjen e seancave gjyqësore duke pasqyruar shkaktun në çdo rast si dhe urdhërimet për marrjen e masave për zhvillimin e seancës vijuese (*njoftimin e palëve, kryerjen e komunikimit me institucionet e tjera, etj.*). Drejtimi i seancës zhvillohet në përgjithësi nëpërmjet urdhrave dhe vendimeve të ndërmjetme të cilat janë të shoqëruara me bazën ligjore përkatëse të tyre, si dhe me arsyet e vendimmarrjes. Gjithashtu rezulton që gjykata ka disponuar me vendime të ndërmjetme mbi çdo kërkesë të parashtruar nga palët në gjykim apo edhe vendimet e ndërmjetme të marra kryesisht.

Seancat gjyqësore të zhvilluara në çështjet e vëzhguara janë dokumentuar në procesverbalin e seancës gjyqësore, mbajtur me regjistrim audio, si dhe me shkrim nga sekretarja gjyqësore.

KONKLUZIONE

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari ka treguar shkallë të lartë aftësie në këtë tregues, evidentuar në korrektësinë e planifikimit, mbikëqyrjes, zhvillimit dhe dokumentimit të veprimeve procedurale, duke respektuar standardet e procesit të rregullt ligjor dhe duke ndjekur në përgjithësi me korrektësi hapat proceduralë të gjykimit penal dhe civil, në seancat gjyqësore të zhvilluara.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në lidhje me treguesin “kryerja e veprimeve procedurale për organizimin e procesit gjyqësor” është “shumë e lartë” duke u pikëzuar me 20 pikë.

2.C Aftësia e gjyqtarit për të administruar dosjen gjyqësore.

2.C.a Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në raportin analitik, rezulton se: Aktet e dosjeve janë renditur në mënyrë të rregullt dhe duke ndjekur përgjithësisht, të njëjtën radhë të renditjes së dokumenteve. Pavarësisht se nuk ka një rregullim që të përcaktojë në mënyrë të shprehur mënyrën e renditjes së akteve në dosjen gjyqësore, renditja duhet të jetë e tillë që të lehtësojë aksesimin e saj dhe në rastin konkret renditja sipas llojit të akteve procedurale por e ndërthurur kjo edhe me veprimet procedurale të kryera nga gjyqtari gjatë gjykimit, është dhe konsiderohet si një mënyrë që e bën të lehtë dhe të aksesueshme dosjen. Brenda kategorisë, aktet renditen sipas datave (*njoftimet, shkresat, procesverbalet e seancave*). Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numërtuara dhe mund të shfrytëzohen pa asnjë vështirësi.

KONKLUZIONE

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se renditja e akteve në dosje, e cila është përgjithësisht e njëjtë dhe ndjek rendin kronologjik, është bërë në mënyrë të tillë që ta bëjë dosjen gjyqësore lehtësisht të aksesueshme. Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numërtuara dhe mund të shfrytëzohen me lehtësi.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit për këtë tregues vlerësohet “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 5 pikë.

2.C.b Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në raportin analitik, rezulton se në dosjet e përzgjedhura me short, ndodhen të gjitha aktet e hartuara nga gjykata (*njoftimet për çdo veprim apo seancë, procesverbalet e çdo seance përgatitore apo gjyqësore, vendimet për caktimin e seancave gjyqësore, vendimet e ndërmjetme të arsyetuara, vendimet gjyqësore*) si dhe aktet e paraqitura nga palët (*kërkesë padia, provat dhe diskutimet përfundimtare të palëve*). Nuk rezultojnë mungesa të dokumentacionit në dosjet e vëzhguara apo prania e akteve dhe dokumenteve që nuk i përkasin çështjes konkrete.

KONKLUZIONE

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se dosjet gjyqësore burim vlerësimi janë të plota dhe përmbajnë të gjitha aktet që i përkasin çështjes konkrete. Po ashtu nuk rezulton prania e akteve që nuk i përkasin çështjes konkrete.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, është “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 10 pikë.

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE

Vlerësimi i kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale bëhet duke u bazuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Pikëzimi për shumicën e treguesve të këtij kriteri bëhet në rend zbritës dhe çdo gjyqtar e fillon procesin e vlerësimit me totalin e pikëve referuar treguesit përkatës, duke zbritur sipas rastit pikët, në varësi të rezultateve të analizës objektive të të dhënave të burimeve të vlerësimit.

3.A Etika në punë

3.A.a Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në raportin analitik, në lidhje me të dhënat që mund të tregojnë cenimin e etikës apo përgjegjshmërisë në funksion të gjyqtarit u konstatuan të dhënat e mëposhtme :

Referuar informacionit të përcjellë prej Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me shkresën nr. 2069/1, datë 20.09.2020 dhe nr. 2069/2 prot., datë 09.02.2021 ka rezultuar se për periudhën 01.01.2019-31.12.2019, për gjyqtarin {...} janë depozituar dy ankesa, të cilat pasi i janë nënshtruar shqyrtimit fillestar prej Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, është vendosur të arkivohen. Konkretisht:

- Ankesa e z. Pal Gega, depozituar pranë KLGJ-së me nr. 2792 prot., datë 20.05.2019, regjistruar më pas pranë ILD-së me nr. 1165 prot., datë 15.06.2020. Përmes kësaj ankese, ankuesi ka ngritur pretendime se gjyqtari {...}, me vendimin nr. 1014, datë 11.12.2012 ka marrë një vendim të njëanshëm për favorizimin e palëve të tjera pretenduese, si dhe ka gjykuar me dy standarde, pasi nuk ka pranuar provat shkresore të depozituara prej ankuesit gjatë seancës gjyqësore. Pas shqyrtimit fillestar të kësaj ankese, është konstatuar se ajo nuk plotëson kushtin e pranueshmërisë pasi është paraqitur përtej afatit 5-vjeçar të parashkrimit. Në këto kushte, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka marrë vendimin nr. 1165/4 prot., datë 07.12.2020 *“Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesës së paraqitur nga shtetasi z. Pal Gega”*.
- Ankesa e z. Pjetër Zefi, depozituar pranë KLGJ-së me nr. 4098 prot., datë 30.07.2019, regjistruar më pas pranë ILD-së me nr. 1251 prot., datë 09.12.2020. Përmes kësaj ankese, ankuesi ka ngritur pretendime mbi vendimin nr. 208, datë 25.03.2019, dhënë prej gjyqtarit {...}. Pas shqyrtimit fillestar të kësaj ankese, është vlerësuar se pretendimet e ngritura prej ankuesit, nisur nga natyra e tyre, janë të tilla që zgjidhen mbi bazën e apelimit gjyqësor. Nga informacioni paraprak i marrë në faqen zyrtare të Gjykatës së Apelit Shkodër, ka rezultuar se vendimi i gjyqtarit {...} është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Shkodër duke mos u konstatuar shkelje të natyrës disiplinore në dhënien e vendimit. Në këto kushte, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka marrë vendimin nr. 1257/41 prot. datë 09.12.2020 *“Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesës së paraqitur nga shtetasi z. Pjetër Zefi.”*.

Referuar përmbajtjeve të vendimeve të arkivimit, edhe pse një prej tyre është jashtë periudhës së rivlerësimit, nuk evidentohen elementë që mund të analizohen në drejtim të respektimit të etikës në punë nga ana e gjyqtarit. Ndërkohë, sa i takon masave disiplinore, ka rezultuar se për periudhën 01.01.2019-31.12.2019 për gjyqtarin {...}, nuk është dhënë ose zbatuar ndonjë masë disiplinore.

Gjyqtari në Formularin e Integruar të Vlerësimit e ka vlerësuar shumë të lartë aftësinë e tij në drejtim të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion duke u shprehur se është kujdesur të përkrahë kolegët në përmbushjen e detyrës, të ndajë e diskutoj me ta problematikat e punës, të jetë i përmbajtur dhe i përfshirë në bashkëpunim me kolegët për përmbushjen e objektivave të gjykatës. ***Kryetari i gjykatës, lidhur me këtë tregues*** e ka vlerësuar gjyqtarin me nivel shumë të lartë etike duke parashtruar se gjyqtari ka aftësi shumë të larta të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në punë, ka etikë dhe integritet të lartë, shfaq sjellje të kujdesshme dhe objektive, me vetëpërmbajtje dhe maturi duke vepruar me korrektësi, ndërgjegjshmeri dhe duke shmangur çdo lloj sjellje që do të cenonte shfaqjen e angazhimit dhe përgjegjshmërisë maksimale në funksion.

KONKLUZIONE

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari reflekton angazhim dhe përgjegjshmeri në funksion dhe nuk ka shfaqur sjellje që mund të cenojë etikën në punë të tij. Për këto arsye, konkludohet se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion.

Shkalla e etikës në punë të gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se shkalla e etikës së gjyqtarit në lidhje me treguesin “angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion” është “shumë e lartë” duke u pikëzuar me 35 pikë.

3.B Integriteti i gjyqtarit

3.B.a Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjteti.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në raportin analitik, në lidhje me këtë tregues u konstatuan të dhënat e mëposhtme :

Referuar informacionit të përcjellë prej Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me shkresën nr. 2069/1, datë 20.09.2020 dhe nr. 2069/2 prot., datë 09.02.2021 ka rezultuar se për periudhën 01.01.2019-31.12.2019, për gjyqtarin {...} janë depozituar dy ankesa, të cilat pasi i janë nënshtruar shqyrtimit fillestar prej Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, është vendosur të arkivohen. Ndërkohë, sa i takon masave disiplinore, ka rezultuar se për periudhën 01.01.2019-31.12.2019 për gjyqtarin {...}, nuk është caktuar apo zbatuar asnjë e tillë.

Referuar raportit të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave për gjyqtaren {...}, përcjellë pranë KLGJ-së me shkresën nr. 218/24 prot., datë 04.05.2021 ka rezultuar se:

- a) Deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
- b) Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë;
- c) Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- d) Nuk ka kryer deklarim të rremë;
- e) Kandidati nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.

Gjyqtari në Formularin e Integruar të Vlerësimit e ka vlerësuar këtë tregues në nivel shumë të lartë, duke u shprehur se është kujdesur të shmangë sjelljet e pahijshme me palët, avokatët apo pjesëmarrësit e tjerë, si gjatë gjykimit e punës, ashtu edhe jashtë tyre. **Edhe Kryetari i Gjykatës** e ka vlerësuar integritetin e gjyqtarit në nivel shumë të lartë.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit nuk rezulton asnjë e dhënë apo indicje që të dëshmojë për ekzistencën e shfaqjeve të pahijshme, cenim të nderit dhe dinjtetit të gjyqtarit, shfaqjen e sjelljeve që tregojnë favor ose disfavor në lidhje me çështjet në gjykim apo çdo sjellje tjetër që mund të cenojë integritetin e gjyqtarit.

KONKLUZIONE

Në tërësi, referuar parimit të prezumimit dhe përcaktimeve të Metodologjisë së Pikëzimit lidhur me këtë tregues, në mungesë të të dhënave që mund të cenojnë integritetin e gjyqtarit, vlerësohet se gjyqtari duhet të pikëzohet me pikët maksimale për këtë tregues, pasi

presumohet se ka shmangur plotësisht shfaqjen e sjelljeve të pahijshme apo sjelljeve që cenojnë nderin dhe dinjitetin e gjyqtarit.

Shkalla e integritetit të gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se në lidhje me treguesin “shmangia e sjelljeve të pahijshme, nderi dhe dinjiteti” aftësia e gjyqtarit është “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 40 pikë.

3.C Paanësia e gjyqtarit

3.C.a Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në raportin analitik, nuk rezulton në asnjë rast përdorimi i gjuhës diskriminuese nga gjyqtari në komunikimin me palët ndërgjyqëse gjatë zhvillimit të seancave apo në përmbajtje të vendimeve përfundimtare të tij. Gjithashtu, nuk ka asnjë të dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese me të tretët, referuar komunikimit shkresor dhe akteve të administruara në dosjet e gjykimit, apo përmbajtjes së formularit të integruar të vlerësimit.

KONKLUZIONE

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit ose përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej tij. Për këto arsye, konkludohet se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese.

Shkalla e integritetit të gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se aftësia e gjyqtarit në lidhje me treguesin “shmangia e përdorimit të gjuhës diskriminuese” është “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 10 pikë.

3.C.b Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit.

Referuar burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në raportin analitik, evidentohet se janë paraqitur 12 kërkesa për përjashtimin e subjektit të vlerësimit, por vetëm 1 rezulton të jetë pranuar. Ndërkohë, rezulton se vetë subjekti i vlerësimit ka paraqitur 24 kërkesa për heqje dorë, nga të cilat 21 janë pranuar. Gjyqtari dhe Kryetari i Gjykatës e kanë vlerësuar të pakonsiderueshëm numrin e kërkesave të pranuar për përjashtimin e gjyqtarit.

KONKLUZIONE

Në tërësi, duke mbajtur në konsideratë parimin kushtetues se çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, duhet të jetë dhe duhet të shfaqë paanësi në funksion, si dhe faktin se referuar të dhënave burimore mbi numrin e kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit vetëm 1 (një) rezulton e pranuar, vlerësohet se numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit është i pa konsiderueshëm.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, në lidhje me treguesin “numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit” gjyqtari pikëzohet me 15 pikë, pasi ky numër vlerësohet si “i pa konsiderueshëm”.

Niveli i vlerësimit KRITERI ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL

Në këtë kriter vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i gjyqtarit në drejtim të aftësive të komunikimit, bashkëpunimit dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale.

4.A Aftësia e komunikimit.

4.A.a Komunikimi i qartë dhe transparent.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në raportin analitik rezulton se gjyqtari gjatë komunikimit me palët dhe pjesëmarrësit në proces është i qartë, transparent, i kuptueshëm. Gjithashtu, evidentohet komunikim i qartë, i saktë dhe konciz gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore, duke e bërë procesin të kuptueshëm për palët dhe për pjesëmarrësit në të. Të njëjtat cilësi rezultojnë edhe në arsyetimin e vendimeve përfundimtare, ku gjuha e përdorur është e thjeshtë, e kuptueshme, e qartë, koncize dhe drejtpërdrejtë.

Të njëjtat cilësi evidentohen edhe në vetëvlerësimin e gjyqtarit dhe vlerësimin e kryetarit të gjykatës lidhur me këtë tregues.

KONKLUZIONE

Në tërësi, nga analiza e integruar e burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari në çdo rast komunikon në mënyrë të qartë dhe transparente me palët dhe pjesëmarrësit në proces, duke treguar kujdes për të qenë i qartë, i drejtpërdrejtë dhe i kuptueshëm.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se shkalla e aftësisë së gjyqtarit në lidhje me treguesin “komunikimi i qartë dhe transparent” është “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 25 pikë.

4.A.b Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në raportin analitik, nuk rezulton asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të dhënave personale dhe për pasojë, prezumohet se gjyqtari ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve apo subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit.

KONKLUZIONE

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të dhënave personale dhe për pasojë, prezumohet se gjyqtari ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve apo subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit.

Respektimi i konfidencialitetit nga gjyqtari dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se shkalla e aftësisë së gjyqtarit në lidhje me treguesin “respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale” është “e lartë” duke u pikëzuar me 15 pikë.

4.B Aftësia për të bashkëpunuar

4.B.a Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në raportin analitik, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indicie për mungesë të bashkëpunimit të gjyqtarit me kolegët, gjatë periudhës së vlerësimit.

Gjyqtari e Kryetari i Gjykatës e ka vlerësuar maksimalisht këtë tregues duke evidentuar se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit të tij me kolegët është në nivel maksimal, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale, përfshirjen në diskutime ligjore, organizimin e punës në gjykatë dhe komunikimin brenda trupave gjyqësore.

KONKLUZIONE

Në tërësi, nga të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët si dhe shkëmbimi i njohurive dhe përvojës profesionale me ta, është shumë e lartë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në lidhje me treguesin “shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta” është “shumë e lartë” duke u pikëzuar me 15 pikë.

4.B.b Shkalla e komunikimit dhe e bashkëpunimit me administratën gjyqësore.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik nuk rezultojnë të dhëna negative për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore ndërkohë që gjyqtari dhe Kryetari i Gjykatës e ka vlerësuar këtë tregues në nivel shumë të lartë duke parashtruar se ka komunikim dhe marrëdhënie shumë të mira me administratën e gjykatës.

KONKLUZIONE

Në tërësi, nga të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtarit me administratën gjyqësore, është shumë e lartë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se shkalla e aftësisë së gjyqtarit në lidhje me treguesin “shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore” është “shumë e lartë” duke u pikëzuar me 10 pikë.

4.C Gatishmëria e gjyqtarit për t’u angazhuar në veprimtari të tjera.

4.C.a Pjesëmarrja e gjyqtarit në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, evidentohet se: Për periudhën 01.01.2019-31.12.2019, gjyqtari {...} ka marrë pjesë në cilësinë e pjesëmarrësit në aktivitetet trajnuese si vijon:

- Në aktivitetin e datës 5 prill 2019 me temë: “*Provat në gjykimin penal. Pranimi dhe përjashtimi i tyre. Çmuarja e provave, teoritë e çmuarjes së saj.*” (prezent vetëm në sesionin e parë).
- Në aktivitetin e datës 10-11 prill 2019 me temë: “*Procedura e shqyrtimit të padive për shuma të vogla, gjykimi i shkurtuar, komunikimi me palët, rregullat për pyetjen e dëshmitarit, arsyetimi i vendimit gjyqësor, si dhe e drejta e ankimit ndaj vendimit.*” (prezent gjatë të dyja ditëve, në të dyja sesionet).
- Në aktivitetin e datës 2-3 maj 2019 me temë: “*Vepra penale në fushën e falimentimit. Roli i ligjit të ri të falimentimit në parandalimin e fshehjes së të ardhurave/pasurisë së debitorit nëpërmjet procedurës së falimentimit.*” (prezent gjatë të dyja ditëve, në të dyja sesionet)⁶².

Sipas parashikimeve të nenit 5 pika 3 të Ligjit për Statusin *periudha e formimit vazhdues duhet të jetë: a) jo më pak se pesë ditë të plota në vit dhe jo më pak se 30 ditë të plota gjatë pesë viteve; b) jo më shumë se 40 ditë në vit dhe 200 ditë gjatë pesë viteve.* Në rastin konkret gjyqtari ka marrë pjesë në 3 aktivitete trajnuese të shtrira në 4,5 ditë trajnimi. Rrjedhimisht, periudha e formimit vazhdues të tij është nën nivelin minimal të parashikuar nga Ligji për Statusin. Në këto kushte, referuar Metodologjisë ai duhet të vlerësohet me 4 pikë.

Pjesëmarrja e gjyqtarit në trajnime dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues pikëzohet me 4 pikë.

4.C.b Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, nuk rezulton të ketë të dhëna që gjyqtari {...} përgjatë vitit kalendarik 2019, të ketë udhëhequr kandidatët për magjistratë gjatë stazhit profesional apo të ketë qenë në rolin e ekspertës/lehtësueses për trajnimin e gjyqtarëve.

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij kriteri, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t’iu shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, vlerësoj se për gjyqtarin {...} duke qenë se nuk rezultojnë të dhëna për angazhimin e tij në cilësinë e ekspertit në aktivitete trajnuese në Shkollën e Magjistraturës, ky tregues pikëzohet me 3 pikë.

⁶² Në vijim të informacionit të përcjellë përmes shkresës nr. 751/1 prot., datë 01.10.2020 të Shkollës së Magjistraturës, sqarohet se: “*Sikundër vihet re edhe nga tabela e mësipërme, z. {...}, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, përgjatë vitit kalendarik 2019, ka marrë pjesë në 3 (tre) aktivitete trajnuese pranë Shkollës së Magjistraturës (në rolin e pjesëmarrësit) konvertuar në numër ditësh: 4,5 (katër presje pesë) ditë.*”.

Disponueshmëria e gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, pikëzohet me 3 pikë.

4.C.c Pjesëmarrja e gjyqtarit në veprimtari ndërinstytucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun në gjykata.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në raportin analitik, nuk rezultojnë të dhëna për vitin 2019 në lidhje me pjesëmarrjen e gjyqtarit në veprimtari ndër institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun në gjykata.

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij treguesi, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'iu shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, vlerësohet se për gjyqtaren {...}, ky tregues duhet të pikëzohet me 3 pikë.

Pjesëmarrja, kontributi i gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues pikëzohet me 3 pikë.

4.C.ç Publikimet ligjore akademike.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, në lidhje me angazhimin e gjyqtarit në veprimtari që përfshijnë publikime ligjore akademike, nuk evidentohen të dhëna për periudhën e vlerësimit 01.01.2019 - 31.12.2019

Publikimet ligjore akademike dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për treguesin “Publikimet ligjore akademike”, gjyqtari pikëzohet me 0 pikë.

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL	
Pikët	Niveli i vlerësimit
75	Shumë mirë

**NIVELIN E VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI DHE
NIVELI I PËRGJITHSHËM I VLERËSIMIT**

Niveli i vlerësimit për çdo kriter		
Kriteri	Pikët	Niveli i vlerësimit
1. Aftësitë profesionale të gjyqtarit	90	Shkëlqyeshëm
2. Aftësitë organizative të gjyqtarit	100	Shkëlqyeshëm
3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale	100	Shkëlqyeshëm
4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional	75	Shumë mirë
Niveli i përgjithshëm i vlerësimit		
Vlerësimi i përgjithshëm	365	Shumë mirë

PROPOZIME DHE REKOMANDIME

Bazuar në nenin 93 pika 5 shkronja “ç” të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, duke iu referuar të dhënave të analizuara dhe vlerësuara në raport me kriteret e vlerësimit, rekomandohet që gjyqtari {...} duhet të respektojë detyrimin ligjor për pjesëmarrje në trajnimin vazhdues, të mbajë në konsideratë angazhimin e tij në veprimtari ndërinstitucionale si dhe në fushën e publikimeve ligjore dhe akademike, me qëllim ndarjen e përvojës profesionale dhe dhënien e kontributit të tij për përmirësimin e sistemit gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

SHTOJCA 1

KRITERET E VLERËSIMIT, SHKALLA E AFTËSISË, PIKËZIMI DHE NIVELI I VLERËSIMIT TË GJYQTARIT {...} PERIUDHA E VLERËSIMIT 2019

1. AFTËSITË PROFESIONALE			
Treguesit		Burimet	Shkalla e aftësisë
A. Njohuritë ligjore	a. Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave	1.Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarit 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë
	b. Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes	1.Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarit 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Mbi mesataren
B. Arsyetimi ligjor	a. Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit	1.Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarit 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë
	b. Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit	1.Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarit 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë
	c. Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik	1.Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarit 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Mbi mesataren
2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT			
Tregues		Burimet	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit

A. Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë	a. Respektimi i afateve ligjore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	0-10 %
	b. Plotësimi i standardeve minimale kohore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	0-10%
	c. Koha mesatare që i dedikohet çdo çështje	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Më e shkurtër se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve
	ç. Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Mbi +99%
	d. Koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve
B. Aftësia e gjyqtarit për të kryer procedural gjyqësore	a. Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive	1. Të dhënat statistikore/aktet e dosjeve të përzgjedhura me short	1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë

		2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	
	b. Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor	1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Shumë e lartë
C. Aftësia e gjyqtarit për të administruar dosjen gjyqësore	a. Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes	1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit	Shumë e lartë
	b. Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes	1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit	Shumë e lartë

3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE

Tregues		Burimi	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit
A. Etika në punë	a. Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion	1. Informacioni i marrë nga ILD 2. Dosja personale e gjyqtarit 3. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 4. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Shumë e lartë
B. Integriteti i gjyqtarit	a. Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti	1. Informacioni i marrë nga ILD 2. Dosja personale e gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit 4. Të dhënat e raportit të ILDKPKI	Shumë e lartë
C. Paanësia e gjyqtarit	a. Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese	1. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim	Shumë e lartë

		2. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short për vlerësim	
	b. Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	I pa konsiderueshëm

4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL

Tregues		Burimi	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit
A. Aftësia e komunikimit	a. Komunikimi i qartë dhe transparent	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim 4. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short	Shumë e lartë
	b. Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim 4. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short	I lartë
B. Aftësia për të bashkëpunuar	a. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Të dhënat për verifikimin e ankesave	Shumë e lartë
	b. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Të dhënat për verifikimin e ankesave	Shumë e lartë
C. Gatishmëria e gjyqtarit për t'u	a. Pjesëmarrja e gjyqtarit në programin e formimit vazhdues në Shkollën e	1. Informacioni i marrë nga	< 5 (Periudha

angazhuar në veprimtari të tjera	Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale	Shkolla e Magjistraturës 2. Dosja personale e gjyqtarit 3. Dokumente të dorëzuara nga gjyqtari	1/vjeçare)
	b. Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve	1. Dosja personale e gjyqtarit 2. Informacioni i marrë nga Shkolla e Magjistraturës ose institucione të tjera	Nuk ka të dhëna
	c. Pjesëmarrja e gjyqtarit në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Dosja personale e gjyqtarit 4. Çdo e dhënë tjetër që tregon ngritjen profesionale të gjyqtarit	Nuk ka të dhëna
	ç. Publikimet ligjore akademike	1. Dosja personale e gjyqtarit 2. Çdo e dhënë tjetër që tregon ngritjen profesionale të tij	Nuk ka të dhëna
PIKËZIMI PËR KATËR KRITERET E VLERËSIMIT			
NIVELI PËRFUNDIMTAR I VLERËSIMIT TË GJYQTARIT			SHUM

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR